

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6107  
E hënë, 7 shtator 2020  
çmimi 0.40 €

Zgjedhjet parlamentare  
në Shqipëri mbahen më  
25 prill të vitit 2021

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KOSOVA DHE SERBIA VAZHDOJNË SOT (E HËNË) DIALOGUN NË BRUKSEL

FAQE 4-5

## HOTI DHE VUÇIQI NË BRUKSEL PËR ÇËSHTJE TË 'NXEHTA' POLITIKE

### OPINION

**FRENOJENI ARROGANCËN  
ZOTI GRENELL, NUK JEMI  
TË GJITHË VEGJETARIANË  
POLITIKË!** F. 11

Shkruan:  
Behxhet Sh. SHALA  
- BAJGORA



**SHËNIM PËR NJË  
KEQKUPITIM TË MADH** F. 11

Nga Edi  
RAMA



### AKTUALE

**TURQIA KUNDËRSHTON  
HAPJEN E AMBASADËS SË  
KOSOVËS NË JERUSALEM** F. 7

**NË HAS U VUNË PLLAKA  
PËRKUJTIMORE NË DY  
SHTËPI, TË CILAT ISHIN  
BAZAT E PARA TË UÇK-së** F. 6

### EKONOMI

**MBI 300 BIZNESE MË PAK  
PARAQITËN KËRKESË PËR  
MBYLLJE SE VITIN E KALUAR** F. 8

**NGORDHIN 30 KRERË DELE NGA  
"GJUHA E KALTËR" NË KOSOVË** F. 8

**"SERBIA NUK MUND  
TA SHFRYTËZOJË UJMANIN,  
AI ËSHTË I DEDIKUAR PËR  
NEVOJA TË KOSOVËS"** F. 8

### SPORT

**MURIOI NGA LUFTA E KOSOVËS  
NË LIGËN E KAMPIONËVE** F. 16



Pas takimit në Shtëpinë e Bardhë, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksander Vuçiq, priten të takohen sot (e hënë) në Bruksel për një raund tjetër bisedimesh politike.

Ndryshe nga takimi i Uashingtonit, ku u diskutua më shumë për normalizim ekonomik të raporteve në mes të dy vendeve, në Bruksel pritet të diskutohen çështje të nxehta politike. Pala e Kosovës ka thënë se

do të diskutohet për marrëveshjen përfundimtare dhe për njohjen reciproke, kurse pala serbe ka paralajmëruar se do të flitet për asociacionin e komunave me shumicë serbe

## AKP-ja thotë se nga tërheqja e mjeteve nuk rrezikohen kreditorët

Në kuadër të Ligjit për rimëkëmbje ekonomike është paraparë edhe tërheqja e mjeteve nga "Fondet e mbetura" pas procesit të likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), të cilat do të transferohen në buxhetin e shtetit. Mirëpo, sipas AKP-së, nga kjo tërheqje nuk do të rrezikohen

kreditorët e as 20-përqindësi i punëtorëve. Njohësi i çështjeve ekonomike, Safet Gërxhaliu, ka thënë se edhe pse AKP-ja është target i këtyre mjeteve, është për keqardhje se si deputetët nuk e kanë kaluar Ligjin për rimëkëmbje ekonomike para se të shkojnë në pushime. **FAQE 8**

**Raporti  
24-orësh i  
IKShPK-së:  
Shtatë të  
vdekur, 115 të  
shëruar dhe  
92 raste të  
reja me Covid**

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri mbahen më 25 prill të vitit 2021

TIRANË, 6 SHTATOR (ER) - Më 25 prill të vitit 2021 shqiptarët do t'u drejtohen qendrave të votimit për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. Kjo datë është dekretuar nga ana e presidentit të Shqipërisë, Ilir Meta, në mbështetje të Kodit Zgjedhor. "Zgjedhjet për

Kuvendin të zhvillohen ditën e diel, më datë 25 prill 2021" është thënë në dekretin e Metës. Kjo datë vjen pas konsultimeve gjatë ditës së premtje në mes të presidentit Meta dhe kryetarëve të partive kryesore politike në Shqipëri. Për kryeministrin dhe liderin e Partisë

Socialiste (PS), Edi Rama, nuk ishte problem data e zgjedhjeve, duke thënë se ishte i gatshëm të pranonte cilëndo datë. Edhe opozita nuk ka dhënë ndonjë datë konkrete, por ka thënë se duhen sa më shpejt dhe se zgjedhjet duhet të jenë të lira e të ndershme.



## Ambasadori i Vatikanit eksploron bukuritë e Shqipërisë, ngjitet në majën e Korabit



TIRANË, 6 SHTATOR - Ta njohësh Shqipërinë duke prekur nga afër bukuritë që ajo ka, por edhe të flasësh me njerëzit e të gjendesh mes situatave që të lidhin më shumë me grigjën që do t'i shërbesh është një "mrekulli". Këtë formë të lidhjes e ka zgjedhur nunci apostolik në Shqipëri, imzot

Charles John Braun, i cili ka mbushur plot tri vjet prej emërimit të tij nga Papa Françesku si përfaqësues i Vatikanit në tokën e shqiptonjave. Për herë të parë larg mantelit të klerikut, por si një udhëtar që do t'i njohë nga afër bukuritë e vendit, traditat, kulturën dhe jetën e njerëzve,

ai ka rrëfyer si ishin këto tri vjet të para të misionit të tij në Shqipërinë e vogël. "Sinqerisht dija pak për vendin tuaj. Për mua ishte një vend misterioz, të cilin doja vërtet ta njihja. Në këto tri vjet kam udhëtuar shumë, vizituar zona të ndryshme, nga Vermoshi në Sarandë. Vërtet jam dashuruar

me Shqipërinë. Është një vend me shumë kualitete. Nuk mund të imagjinohet bukuria e natyrës, plazhet e bukura dhe malet madhështore. Pastaj ka edhe një kulturë interesante që ndërthuret nga shumë elemente, që për mua si Amerikan e bën vendin tuaj shumë tërheqës. Njerëzit

shpesh këtu ankohen për situatën ekonomike, apo probleme të tjera, por me sytë e mi unë shoh më shumë elementë pozitivë. Bukuria e natyrës, mirësia e njerëzve, mirëpritja që gjendet kudo në këto troje, e kjo bën pjesë në kulturën tuaj. Si katolik pastaj më duhet ta them, vlerat e familjes janë ende shumë të forta, sa nuk i gjen thuajse askund. Është një avantazh i madh për ju", ka thënë ai për "Oranews", duke treguar përshtypjet e tij edhe për malin e Korabit. "Kur flitet për Korabin, këtu në kufirin mes dy vendeve, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, më lind në një tjetër mendim. Tek Nënë Tereza, e lindur në Maqedoninë e Veriut, shenja e njohur në të gjithë botën, që na paraqet këtë aspekt religjioz të popullit shqiptar. Iku në qiell 23 vjet më parë, por ndërsa jemi këtu mes malesh, më kujtohet ajo e bardha dhe bluja e veshjes së saj dhe duke qenë këtu në këtë lidhje hapësinore mes dy vendeve, me vjen natyrshëm lidhja e fortë që ajo kishte me Zotin dhe sa shumë e donte këtë vend", ka thënë ai.

## Abazoviqi: Kryeministër duhet të jetë ai që e çon Malin e Zi në BE

PODGORICË, 6 SHTATOR - Kryeministër i Malit të Zi do të zgjedhet ai që do të punojë drejt Bashkimit Evropian (BE) dhe prosperitetit të vendit. Kështu është shprehur Dritan Abazoviqi, drejtues i koalicionit "E zeza mbi të bardhë". Abazoviqi ka theksuar se qeveria e re do të punojë vetëm drejt Bashkimit Evropian, ndërsa ka thënë se kryeministri i ardhshëm i Malit të Zi duhet të jetë një person i gatshëm për të kontribuar për vendin. Abazoviqi ka theksuar se qeveria në ikje e Gjokanoviçit është e akuzuar për krim dhe korrupsion. Më tutje, Abazoviqi ka thënë se imazhi i shqiptarëve në Mal të Zi tashmë është në rritje, duke premtuar se koalicioni i tij do të punojë në

drejtim të përmirësimit të gjendjes së tyre. Ai ka thënë se është kërcënuar, por ka theksuar se nuk do t'u largohet përgjegjësiave politike. Dritan Abazoviqi ka folur edhe për marrëdhëniet me politikanët shqiptarë, ku ka thënë se pas zgjedhjeve të 30 gushtit ka marrë mjaft mesazhe urimi. "Koalicioni ynë synon integrimin në Bashkimin Evropian. Qeveria jonë do të punojë në interes të qytetarëve. Unë nuk u largohem përgjegjësiave politike. Më kanë kërcënuar, por nuk viktimizohem!", ka thënë ai, duke dhënë përgjigje nëse do të jetë kryeministër i ri i Malit të Zi. "Nuk e di a do të jetë ajo zgjedhje. Nuk jam i interesuar a do të vijoj në atë drejtim. Kryeministri i Malit


të Zi duhet të jetë dikush që do të punojë në interes të qytetarëve dhe do ta çojë Malin e Zi në BE. Nuk ka rëndësi a është Dritan apo kush tjetër. Shumë sfida i kam marrë përsipër dhe nuk u kam ikur as tani. E di që është shumë e vështirë, por këtu jam. I gatshëm të jap çdo kontribut", është shprehur ai. Në këtë kontekst, Abazoviqi ka thënë se nuk ka qeveri pa lëvizjen që drejton. "Vetë prania në politikë ka ardhur në një impakt. Imazhi i shqiptarëve një nivel është rritur. 30 vjet ne nuk kemi sukses. Unë mendoj se nuk ka për të qenë aspak zor për të qenë më i suksesshëm se qeveria e mëparshme, por ne kemi qejf të jemi shumë më të suksesshëm. Zëri im dhe i



partive të tjera ka për të qenë për përmirësimin e standardit të jetesës të të gjithë qytetarëve", është shprehur Abazoviqi. Sa i përket komunikimit me politikanët shqiptarë, ai është shprehur i gatshëm për të bashkëpunuar. "Kam marrë mesazhe urimi,

nuk kanë qenë prej kryesisë, por edhe deputetë në Kuvendin e Shqipërisë. I jam mirënjohës. Jam i hapur për bashkëpunim. Mendoj se kemi bërë punë të madhe, por një punë e madhe është në vazhdim", ka thënë Abazoviqi.

# Raporti 24-orësh i IKShPK-së: Shtatë të vdekur, 115 të shëruar dhe 92 raste të reja me Covid



Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë kanë vdekur shtatë persona si pasojë e infektimit me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe janë shëruar 115 persona dhe janë paraqitur 92 raste të reja me virusin "Korona". "Numri total i rasteve pozitive është 14 119 raste nga 54 011 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 563 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 115 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 10 546 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 010", ka njoftuar IKShPK-ja

**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur shtatë persona si pasojë e infektimit me virusin "Korona". Po ky institut ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe janë paraqitur edhe 92 raste të reja me Covid dhe janë shëruar 115 persona. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR dhe në laboratorët privatë, janë testuar gjithsej 457 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 92 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 7 raste të vdekjes me SARS-CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 14 119

raste nga 54 011 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 563 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 115 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 10 546 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 010", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar edhe rastet e reja sipas komunave. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 39 raste, komuna Prizren 10 raste, komuna Gjakovë 9 raste, komuna Ferizaj 5 raste, komuna Fushë Kosovë 5 raste, komuna Drenas 4 raste, komuna Vushtrri 3 raste, komuna Istog 2 raste, komuna Podujevë 2 raste, komuna Rahovec 2 raste dhe me nga një rast komunat Deçan, Gjiilan, Han i Elezit, Kamenicë, Lipjan, Obiliq, Pejë, Shtime, Skenderaj, Suharekë dhe Viti", ka njoftuar IKShPK-ja.

## Institucionet shëndetësore mobilizohen për valën e dytë të Covidit

Komiteti për koordinimin dhe vlerësimin e situatës emergjente me koronavirus Covid-19 gjatë fundjavës ka bërë një përmbledhje të situatës epidemiologjike në Kosovë. Në takimimin e këtij komiteti ka marrë pjesë edhe ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj. Me këtë rast, Zemaj ka falënderuar anëtarët e këtij komiteti për gatishmërinë që janë duke treguar gjatë gjithë kohës për menaxhim sa më të mirë dhe efikas të situatës epidemiologjike. "Bazuar në të dhënat nga IKShPK-ja dhe ShSKUK-ja, në 2-3 javët e fundit kemi një rënie të lehtë graduale të numrit të personave të infektuar nga

Covid-19, gjithashtu edhe një rënie domethënëse e numrit të pacientëve të spitalizuar në QKUK dhe në spitalet e përgjithshme, por edhe rënie e vdekjeve të pacientëve të infektuar me Covid-19. Kjo u jep një lloj frymëmarrjeje profesionistëve shëndetësorë, por edhe neve si institucione vendimmarrëse, për t'u rimobilizuar për fuqizimin e kapaciteteve për të pritur një valë tjetër eventuale të Covid-19 gjatë vjeshtës", ka thënë Zemaj, duke shprehur që rënia e rasteve të reja me Covid të reflektojë edhe në uljen e numrit të vdekjeve.

"Duhet të theksojmë se rënia e numrit të infektuarve është rezultat i zbatimit të masave të qeverisë në një nivel më të mirë nga qytetarët, sidomos bartjes së maskës mbrojtëse falë edhe përkushtimit të Policisë së Kosovës dhe inspektorateve përgjegjëse, të cilët përmes punës në terren kanë kontribuar në këtë drejtim, pa lënë anash edhe fushatat informuese që bartjen e maskës e kanë promovuar, përveç si mbrojtje, edhe si një lloj kulture shëndetësore. Ne kërkojmë që me këto masa të vazhdohet edhe më tej, pa rënie të kondicionit në punë, duke i dhënë rëndësi edhe ruajtjes së distancës si një masë tjetër mbrojtëse kundër Covid-19. Te kjo pikë jemi ende keq, si në gastronomi, po ashtu edhe në veprimtari të tjera", ka

deklaruar Zemaj.

Më tutje, ai ka thënë se mbajtja e këtyre masave është jashtëzakonisht e rëndësishme sidomos tani në prag të fillimit të vitit të ri shkollor. "Presim që Ministria e Arsimit dhe Shkencës si dhe komunat t'i kryejnë përgatitjet e duhura për fillimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, sipas skenarëve të paraparë, derisa kërkojmë që rreth kësaj teme, sikurse edhe për të tjerat, të jemi të koordinuar në maksimum, ashtu që fillimi i vitit shkollor të fillojë mbarë, pa rrezikuar shëndetin e nxënësve dhe mësimit në tërësi. Sa iu përket masave të tjera, qoftë në kuptim të lehtësimit të masave apo edhe ashpërsimit të tyre, ato do të ndërmerren sipas situatës epidemiologjike në terren", është shprehur Zemaj, duke shtuar se në vjeshtë do t'i sigurojnë vaksinat kundër gripit sezonal. "Jemi të vetëdijshëm se presioni për të liruar veprimtari të tjera është në rritje e sipër sidomos nga bizneset, banjat rehabilituese, ndryshime të orareve të qarkullimit, kinematë dhe veprimtari të tjera, por duke qenë se jemi në një fazë delikate, në prag të fillimit të vitit shkollor dhe neve na duhet të ulim edhe më tej lakoren e infektimit dhe rastet e vdekjeve, konsideroj se së paku edhe për disa ditë apo javë, masat e njëjta duhet t'i mbajmë në fuqi", ka thënë Zemaj.

## Në spitalet e Kosovës po trajtohen 277 pacientë me Covid-19

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar të dielën se në institucionet publike shëndetësore në Kosovë aktualisht në trajtim janë 375 pacientë. Prej tyre, 277 janë të infektuar me koronavirusin e ri që e shkakton sëmundjen Covid-19. Në raportin ditor të

ShSKUK-së është thënë se 6 pacientë janë në respiratorë, 20 janë duke u trajtuar me makinat e frymëmarrjes CPAP, kurse 260 të tjerë janë në oksigjenoterapi. Kosova ka gjithsej 700 shtretër në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet rajonale.



KOSOVA DHE SERBIA VAZHDOJNË SOT (E HËNË) DIALOGUN NË BRUKSEL

# HOTI DHE VUÇIQI NË BRUKSEL PË

Pas takimit në Shtëpinë e Bardhë, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, priten të takohen sot (e hënën) në Bruksel për një raund tjetër bisedimesh politike. Ndryshe nga takimi i Uashingtonit, ku është diskutuar më shumë për normalizim ekonomik të raporteve në mes të dy vendeve, në Bruksel pritet të diskutohen çështje të nxehta politike. Pala e Kosovës ka thënë se do të diskutohet për marrëveshjen përfundimtare dhe për njohjen reciproke, kurse pala serbe ka paralajmëruar se do të flitet për asociacionin e komunave me shumicë serbe



**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Sot (e hënën) do të mbahet një raund i ri dialogut në nivelin më të lartë politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Bruksel. Ndryshe nga takimi i 4 shtatorit në Uashington, ku u bisedua dhe u arrit marrëveshja ekonomike, kësaj radhe kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, pritet të diskutojnë për çështje politike. Udhëheqësi i delegacionit i Kosovës ka thënë se do të diskutohet për njohje të ndërsjellë, kurse udhëheqësi i delegacionit serb ka paralajmëruar se do të ngrehet çështja e asociacionit të komunave me shumë serbe. "Bazuar në zotimet që i kemi dhënë në Samitin e Parisit më 10 korrik 2020, si dhe mbështetjen që kemi marrë

nga presidenti Makron dhe kancelarja Merkel, të hënën në Bruksel e takojmë palën serbe për të dialoguar për marrëveshjen përfundimtare për njohje reciproke dhe normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka deklaruar kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se në këtë proces nuk do të ketë marrëveshje të ndërmjetme, apo parciale që nuk e zgjidh problemin përgjithmonë.

"Marrëveshja arrihet vetëm atëherë kur përmbillet me njohje reciproke. Nuk do të ketë marrëveshje të ndërmjetme, parciale apo kreative që nuk e zgjidh problemin përgjithmonë. Do të ketë vetëm marrëveshje përfundimtare për njohje reciproke, që është sistematike dhe ku përfshihen të gjitha çështjet që duhet të adresohen

në mes të dy vendeve të pavarura duke u bazuar në konventat, standardet dhe praktikën ndërkombëtare të rregullimit të marrëdhënieve në mes të dy vendeve të pavarura. Kosova mbetet e përkushtuar për paqe, stabilitet, zhvillim dhe integrim

euroatlantik të të gjithë regjionit", ka shkruar Hoti. Kurse presidenti serb Aleksandar Vuçiq ka thënë se përfaqësuesi special i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, këmbëngul për dialog politik të Kosovës dhe të Serbisë. "BE-ja

padyshim se dëshiron një rol kyç për veten dhe dëshiron që ajo të jetë bartësja e këtij procesi. Ajo po analizon atë që është bërë në Uashington dhe mendoj se dëshiron të përdorë një pjesë të asaj që është arritur në Uashington për të bërë përparim më të shpejtë. Se a



## Hoti takohet me Palmerin dhe Lajçakun: I lumtur që po shoh koordinim të BE-së dhe ShBA-së për marrëveshjen finale

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, të dielën është takuar në Bruksel me emisarin special të BE-së për dialog në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, dhe zëvendësdihmësekretarin e Departamentit të Shtetit të ShBA-së, Matthew Palmer. Hoti ka thënë me Lajçakun dhe Palmerin ka diskutuar për zhvillimet në dialog. "Jam shumë i kënaqur që po shoh koordinim të plotë në mes të BE-së dhe ShBA-së lidhur me marrëveshjen finale në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

# R ÇËSHTJE TË 'NXEHTA' POLITIKE



të cilët do të çojnë drejt kësaj marrëveshjeje përfundimtare. "Takimi në Uashington ka pasur një rëndësi të jashtëzakonshme dhe është e pritshme që ky ritëm të vazhdojë edhe në takimin në Bruksel. Tani kemi hyrë në një fazë të konkretizimit të çështjeve dhe një gjë e tillë do të bëhet hap pas hapi. Është

iluzion të pritët ndonjë arritje e madhe në Bruksel, por ajo që duhet të bëhet atje që të vazhdojë aspekti i konkretizimit të çështjeve siç ndodhi edhe në Uashington", ka thënë Muhaxheri. Takimi në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë vjen pas një takimi që palët patën në Shtëpinë e Bardhë në

Uashington më 4 shtator, ku u nënshkrua marrëveshja për normalizimin ekonomik mes dy shteteve. Faza finale e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka rinisur në Bruksel më 16 korrik. Në takimet e zhvilluara së fundi në Bruksel, është diskutuar për të zhdvendosurit, të pagjeturit dhe bashkëpunimin ekonomik.

## Hyseni: Ka përafrim të qëndrimeve që çojnë në një marrëveshje gjithëpërfshirëse për njohje reciproke

Koordinatori shtetëror i Kosovës për dialogun me Serbinë, Skender Hyseni, ka bërë me dije nga Brukseli se ka përafrim të qëndrimeve të palës serbe dhe asaj të Kosovës për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për njohje reciproke. "Jemi afër, sot kanë qenë pak konstruktive këmbimet, qëndrimet, mendimet. Ka mbetur shumëçka për të rrumbullakuar nesër në nivel të lartë. Sonte do të diskutojmë edhe veç e veç për çështjet që kanë mbetur më kontestuese. Ka përafrim të

dukshëm të qëndrimeve për ato që po i quaj elemente të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për njohje reciproke", ka thënë Hyseni. I pyetur nga gazetarët se a ka optimizëm që deri të hënën (sot) në takimet e liderëve të vijë deri te përmbyllja e çështjeve që ka të bëjë me të zhdukurit, të zhdvendosurve dhe bashkëpunimin ekonomik, Hyseni ka thënë se ka përafrim dhe se, sipas tij, nuk bëhet fjalë për marrëveshje të veçantë, janë zotime parimore që këtyre

temave t'u qasen në një ambient mirëbesimi pas nënshkrimit të marrëveshjes gjithëpërfshirëse. "Në takimin e parë në nivel të lartë ka pasur një pajtim që të trajtohen pretendimet financiare nga të dyja palët, ndërkaq për asociacionin ne nuk jemi në dijeni, por ky është një tip dialogu që nuk paragjykon apo nuk parapërdhuron mundësinë që secila palë të nxjerrë një temë në tavolinë dhe ne jemi të gatshëm të trajtojmë çfarëdo teme që del në tavolinë", ka thënë Hyseni.

janë më të lumturit në botë - kushdo që do t'ju thoshte atë - nuk do ta thoshte të vërtetën," ka thënë Vuçiqi gazetarëve, pas një takimi me të dërguarin special të sekretarit të shtetit të ShBA-së për rajonin, Mathew Palmer. Ai ka deklaruar se dialogu me Kosovën është detyrim i shtetit të cilin e ka marrë nga paraardhësit. "Nëse do të më pyesnit nëse do ta pranoja atë më 2009 dhe 2010, kur autoritetet tona e pranuan, unë nuk do ta pranoja, por u votua në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe është detyrimi ynë sot dhe ne nuk mund të zgjedhim. Ne jemi në rrugën evropiane dhe ne duhet t'u besojmë partnerëve tanë nga Evropa", ka thënë ai.

### Kosova pret që Brukseli të përkushtohet si Uashingtoni

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova ka hedhur një hap të madh përpara me marrëveshjen në Uashington. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se tani pret që edhe Bashkimi Evropian ta tregojë përkushtimin dhe seriozitetin e njëjtë në këtë proces. "Kosova hodhi një hap të madh përpara me marrëveshjen në

Uashington. Me njohjen e Kosovës nga shteti i Izraelit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe një herë dëshmuar lidhësi botëror dhe konfirmuan interesin strategjik për paqe, prosperitet ekonomik e stabilitet në Kosovë dhe rajon", ka shkruar ai. Haradinaj ka kërkuar nga Bashkimi Evropian angazhim për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga pesë shtetet evropiane si dhe përmbushjen e premtimit për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. "Tani pritjet tona janë që edhe Bashkimi Evropian ta tregojë përkushtimin dhe seriozitetin e njëjtë, duke lehtësuar procesin e njohjes së Kosovës nga shtetet e saj, që ende nuk e kanë njohur Kosovën, si dhe përmbushjen e premtimit për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Lutjet tona shkojnë drejt Papa Françeskut, me shpresën që shpejt edhe Selia e Shenjtë do ta njohë Kosovën tonë shtet të pavarur e sovran. Vetëm të bashkuar, me besim e mirëkuptim, mund t'ia dalim", ka shkruar Haradinaj. Edhe njohësit e rrethanave politike në vend presin që dinamika e procesit në Bruksel të vazhdojë me atë të Uashingtonit. Analisti politik Artan Muhaxhiri pret që në takimin e 7 shtatorit të ketë hapa të mëtutjeshëm konkretë



## Kryeministri Hoti nesër takohet me sekretarin e NATO-s

BRUKSEL, 6 SHTATOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se nesër (e martë) do të takohet me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens

Stoltenberg. Në profilin e vet në "Facebook", Hoti ka shkruar se Kosova është e bekuar me miqtë e vet. "Të martën, në selinë e NATO-s në Bruksel, takohem me sekretarin e

përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, të cilin e falënderoj për gatishmërinë. Kosova është e bekuar me miqtë e vet, në të dyja anët e Atlantikut", ka shkruar Hoti.

# SHËNIM PËR NJË KEQKUPTIM TË MADH



Shkruan: Edi RAMA

Kosova firmosi një marrëveshje të re me Serbinë. Bukur! Çdo komunikim, takim, marrëveshje drejt paqes përfundimtare, mes dy vendesh që e kanë mbaruar luftën mes vete, është në vetvete diçka pozitive. Të komunikosh me armikun nuk është asnjëherë e gabuar në vetvete; as në mes të luftës, kur kjo është e nevojshme dhe e mundur. E gabuar në vetvete është të mos komunikosh kur e kërkon nevoja dhe krijohet mundësia. Ndërsa të mos komunikosh e të mos takohesh dhe madje të predikosh të kundërtën, e të etiketosh si tradhtarë ata që e bëjnë këtë, kur lufta ka mbaruar e kur armiku i deridjeshëm është fqinji i sotëm e i nesërm me të cilin ende s'ke mbyllur hesapet e paqes, kjo është jo thjesht e gabuar! Është e fajshme.

Nuk e kam dyshuar asnjë çast që do të vinte dita që Kosova do ta pranonte "Minishengenin" e ashtuquajtur - për mua është Shengen Rajonal, aspak

"mini"! Më ka "lodhur" vetëm refuzimi i pafundmë, koha e humbur kot me shumicë, kompleksimi i dëmshëm i faktorëve racionalë në politikën e Kosovës; të cilët u strukën brenda guaskës së absurdit të krijuar nga fansat e turbofolk-nacionalizmit provincial, që e futi Kosovën në një rrugë qorre defaktorizimi ndërkombëtar e ftohjeje me aleatët e saj më të mëdhenj, sidomos Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Gjermaninë. Humbëm jo vetëm kohë e reputacion, me atë taksën e famshme që do gjunjëzonte Serbinë dhe që u kthye në gjobë e lojës së brendshme elektorale duke plagosur Kosovën, po humbëm edhe shanse që s'përsëriten në ndeshjen politike e diplomatike me Serbinë.

Them humbëm në numrin shumë, sepse unë nuk e ndaj dot Kosovën nga Shqipëria, sidomos kur vjen puna tek ajo ndeshje, ku autogolat e dy qeverive të mëparshme të Kosovës kanë qenë njëri më spektakolar se tjetri. Dhe ku Serbia u kthye në armë në duart e turbofolk-nacionalistëve të Prishtinës, që bashkë me ca aleatë gjysmagjela në Tiranë gjuanin ajrin, duke helmuar e çoroditur njerëzit me demokraci në mbrojtje të kufijve, po në fakt vetëm për të sunduar

brenda kufijve! Asisoj Beogradi mbeti i pasfiduar realisht për të avancuar në procesin e normalizimit drejt paqes përfundimtare, ndërkohë që Prishtina u bë teatri i një lufte vulgare për pushtet, mes "patriotëve" dhe "tradhtarëve", në daç atje e në daç në Tiranë. Çfarë humori i zi me njerëzit e sidomos me zgjedhësit në Kosovë!

E lexova me vëmendje marrëveshjen e nënshkruar në Zyrën Ovale dhe përtej kënaqësisë që u arrit, falë përfshirjes së Shteteve të Bashkuara - si edhe përtej lajmit fantastik të njohjes së Kosovës nga Izraeli (fort e rëndësishme e me rrjedhime potenciale shumë kuptimplota për ata që dinë ta lexojnë këtë fakt) - kam ndjesinë e hidhur të faktit se çka është firmosur dje, s'ka asgjë që nuk është pjesë e planit të kahershëm për Shengenin Rajonal, rrjedhojë logjike e procesit të Berlinit, ndërkohë që koha e humbur deri dje është rrëqethëse. Inshallah të ketë mbaruar me kaq vrasja e pamëshirshme e saj, po kam frikë se jo dhe inshallah ta kem gabim!

Ajo që në shqip u damkos me vite si tradhti kombëtare, në anglisht u kthye brenda një dite në arritje historike. Lexova pikën e marrëveshjes ku flitet për një infrastrukturë tokësore që do të nxjerrë Serbinë dhe

Kosovën në një port të thellë në Adriatik. Në Durrës i bie, sepse është lafi për atë rrugën Nish - Prishtinë - Durrës, që Saliu e ka pagëzuar si "rruga e turpit të tradhtisë së Edvin Zografit"! Ajo rrugë ka qenë në tryezën e çdo raundi të Procesit të Berlinit, madje Albini pat kujtuar se dolën në shesh hartat e ndarjes së Kosovës, kur pa një foto nga Berlino ku ishte kancelarja e Gjermanisë, Hashimi, presidenti i Serbisë dhe unë duke parë vijën e asaj rruge mbi një hartë të Ballkanit Perëndimor! O Zot!

Tani hajde ma thoni, si të mos më kujtohet mua që kur Aleksandër Vuçiqi erdhi në Durrës pas tërmetit, m'u turrën e më bënë Esad Pashë që nxora Serbinë në det, ndërsa sot që "Minishengenin" në tokë, det dhe ajër është bekuar në Shtëpinë e Bardhë, shumica e damkosësve përshëndesin marrëveshjen, madje edhe vetë puseta digjitale sb nuk bëzan(?)!

S'ka asnjë problem për mua personalisht kuptohet, e kam mësuar që në kësi rastesh, kur tregon me gisht hënën "patriotët" i turren gishtit! Po këtu ka një problem të madh, shumë të madh, me NE, Shqipërinë dhe Kosovën bashkë, ku i paguajmë kosto të tmerrshme politikës së poshtër të ca bajraktarëve hileqarë, këtej e andej bjeshkëve, të cilët

për dëlirin e tyre të madhëstisë dhe etjen e tyre për pushtet, helmojnë popullin pa pushim me gjuhën e urrejtjes, akuzat e përbindshme, shpifjet e pambarimta, duke pozuar si patriotët të zjarrtë e duke ndezur përditë zjarrin e dasisë mes shqiptarëve! Dhe problemin e bën të madh fakti se rëndom në kurthin e gjuhës së këtyre hipokritëve të pafre, bien plot shqiptarë të sinqertë, të cilët një Zot e di se kur do ta mësojnë erën e këtyre leckave të djegura, që i djegin kaq shumë energji dhe kohë të çmuar Kosovës, Shqipërisë, kombit shqiptar.

Më mirë vonë se kurrë thotë populli, dhëntë Zoti marrëveshja e djeshme të shërbejë për t'u kthjelluar e qytetëruar pak më shumë mjedisi politiko-mediatik dhe për t'u lehtësuar e pse jo, maturuar disi, ajo pjesë e opinionit publik që "u çmend" me sinqeritet prej keqkuptimit të madh të "Minishengenit". Për këtë mundësi të re kthjellimi e maturimi, duhen falënderuar miqtë e mëdhenj amerikanë dhe kryeministri i urtë e i vendosur i Kosovës, Avdullah Hoti, i cili përmbylli me kurajo e sukses, një përpjekje të mundimshme të "tradhtarit të kombit" Hashim Thaçi.

Ndeshja për njohjen përfundimtare vazhdon, urime edhe një herë dhe paj Zotin, mendjen në vend herë tjetër!

## NË HAS U VUNË PLLAKA PËRKUJTIMORE NË DY SHTËPI, TË CILAT ISHIN BAZAT E PARA TË UÇK-së

Has, 6 SHTATOR - Në Nikoliq dhe Vlahën të Hasit të pjesës administrative të Shqipërisë janë vënë pllaka përkujtimore në dy shtëpi, të cilat ishin bazat e para të UÇK-së. Në Nikoliq, në shtëpinë e Sali Jakut dhe në Vlahën, në shtëpinë e Alush Gradicës. Këto dy shtëpi që në ditët e para ishin shndërruar në baza të fuqishme të krerëve dhe ushtarëve të UÇK-së, disa prej të cilëve sot janë dëshmorë të atdheut. Në mesin e tyre edhe Fehmi e Xhevit Lladrovci, Luan Haradinaj, Bekim Berisha - Abeja, Ismet Jashari-Kumanova, Agim Çela etj. Madje dy djem të familjes së Sali Jakut, në shenjë

nderimi, sot mbajnë emrat e Adem Jasharit e Bekim Berishës. Vendosja e këtyre pllakave përkujtimore është bërë me një ceremoni madhështore, me një pjesëmarrje masive të banorëve të Hasit, të të dyja anëve, si dhe të shumë ish-ushtarëve dhe komandantëve të UÇK-së, në mesin e të cilëve edhe Kadri Veseli, i cili këto dy shtëpi i kishte pasur konakë të sigurt gjatë periudhës së luftës. Manifestimet në fjalë i ka udhëhequr Nexhat Çoçaj dhe janë organizuar nga OVLUÇK-ja si ajo qendrore, po ashtu edhe ajo e degës së Hasit. Gjatë këtij manifestimi është thënë se Hasi dhe hasjanët luftës për liri



të Kosovës i kanë dhënë shumë, duke u bërë shembull se si duhet punuar dhe sakrifikuar për lirinë e atdheut. Gjatë luftës së UÇK-së, Hasi ka dhënë

dhjetëra dëshmorë dhe qindra martirë, gjaku i të cilëve është bërë gurthemel i fuqishëm i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës.

# Turqia kundërshton hapjen e Ambasadës së Kosovës në Jerusalem

Zotimi i Republikës së Kosovës, se pas njohjes nga shteti i Izraelit, ambasadën do ta hapë në Jerusalem, ka nxitur reagime. Një gjë të tillë e ka kundërshtuar Turqia, e cila ka qenë ndër shtetet e para që e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Përmes një njoftimi për media, Ambasada e Turqisë në Prishtinë ka vlerësuar se një veprim i tillë është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Gjithashtu, ky zotim i Kosovës është kundërshtuar edhe nga Liga Arabe



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Ambasada e Turqisë në Prishtinë ka kundërshtuar zotimin e Republikës së Kosovës për ta njohur Jerusalemin kryeqytet i Izraelit. Përmes një njoftimi për media, kjo ambasadë ka vlerësuar se një veprim i tillë përbënte një shkelje të qartë të së drejtës ndërkombëtare. “Nga postimet në mediat sociale të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministrit Hoti dhe ministres të Punëve të Jashtme, Meliza Haradinaj-Stublla, është kuptuar se, përveç njohjes reciproke të Kosovës dhe Izraelit, një angazhim është bërë edhe nga Kosova për të hapur një ambasadë në Jerusalem. Është zhgënjyese që një hap i tillë, i cili do të përbënte një shkelje të qartë të së drejtës ndërkombëtare, të merret në konsideratë nga autoritetet e Kosovës”, është thënë në reagimin e

ambasadës turke në Prishtinë. Në reagim është thënë se Turqia është një nga vendet e para që njohu Kosovën, e cila ka siguruar mbështetje të madhe për përpjekjet drejt njohjes ndërkombëtare të këtij vendi që nga fillimi. “Sidoqoftë, ne nuk e shohim të drejtë që ky proces të ndërtohet në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, veçanërisht mbi vuajtjet e popullit palestinez, territoret e të cilat janë nën okupim. Është theksuar vazhdimisht nga rezoluta të ndryshme të OKB-së që konflikti palestinez mund të zgjidhet vetëm përmes krijimit të një shteti të pavarur, sovran dhe të afërt të Palestinës bazuar në kufijtë e 1967-s me Jerusalemin Lindor si kryeqytet. Ne i bëjmë thirrje udhëheqjes së Kosovës që të veprojë në përputhje me këto rezoluta dhe të përmbahet nga veprimet që do ta dëmtonin statusin historik dhe ligjor të Jerusalemit dhe që do të parandalonin që Kosova të

njihet nga shtetet e tjera në të ardhmen”, është thënë në reagimin e Ambasadës së Turqisë.

Këtë zotim të Republikës së Kosovës e ka kundërshtuar edhe sekretari i përgjithshëm i Ligës Arabe, Ahmed Aboul Gheit. Përmes një deklarate për media, Gheit ka e ka kundërshtuar edhe Serbinë e cila është zotuar se ambasadën do ta zhvendosë në Jerusalem. Sipas Gheit, zotimet e tilla janë në kundërshtim me vendimin e Kombeve të Bashkuara, të drejtën ndërkombëtare dhe rezolutën e Këshillit të Sigurimit. Sipas tij, vendet janë

të ndaluara të vendosin ambasadat në Jerusalem pasi ky vend cilësohet i okupuar. Ndërsa zotimi i Kosovës është mirëpritur nga Jerusalemi. “Ne e shohim vendimin e Kosovës dhe të Serbisë, që t’i vendosin ambasadat e tyre, si hap simbolik drejt promovimit të paqes në mes këtyre shteteve. Qyteti i Jerusalemit, kryeqyteti i përgjithshëm i shtetit të Izraelit, do të përbëjë një urë paqeje për tërë botën. U bëj thirrje shteteve të tjera që t’i ndjekin këto hapa dhe t’i vendosin ambasadat e tyre në Jerusalem, kryeqytetin e Izraelit”, ka thënë zëdhënësi i Ministrisë së

Jashtme të Izraelit, Gabi Ashkenzi.

Më 4 shtator në Shtëpinë e Bardhë, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në prani të presidentit Trump, nënshkruan marrëveshjen për normalizim ekonomik. Pjesë e kësaj marrëveshje ishte që Kosova dhe Izraeli të pajtohen të njohin njëri-tjetrin. Ndërsa kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se Kosova është e vendosur që ta hapë ambasadën në Jerusalem dhe të vendosë marrëdhënie diplomatike dhe t’i thellojë marrëdhëniet dypalëshe.

## Haxhiu: Marrëveshja tregon pse u hoq reciprociteti ndaj Serbisë

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Anëtarja e Kryesisë e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, ka vlerësuar se marrëveshja e nënshkruar në Uashington tregon arsyet pse qeveria Hoti ka hequr reciprocitetin ndaj mallrave serbe. Në profilin e vet në “Facebook”, ajo ka shkruar se marrëveshja ekonomike e cila u nënshkrua në Shtëpinë e Bardhë nuk përmend askund kufijtë shtetërorë. “Tash e kemi edhe më të qartë se çka paraqiste reciprociteti. Ishte përballja e Serbisë në secilën sferë të shtetit me shtetësinë e Republikës së Kosovës. Ishte mekanizmi që vinte në pah se ku i dhemb palës tjetër. Marrëveshja e ashtuquajtur për normalizimin ekonomik vë në pah më së shumti arsyen se pse u hoq reciprociteti si raport i barabartë mes shtetesh: Nuk

patëm marrëveshje bilaterale mes dy shtetesh, sepse Serbia nuk do ta shoh Kosovën si Republikë; Nuk përmenden askund kufijtë shtetërorë, përmenden vetëm si pika administrative dhe hiqen fare përmes mini-shengenit, sepse kështu Serbia nuk do të përballet me kufijtë dhe dokumentet e Republikës së Kosovës; Serbia i arrin të gjitha këto pa pasur nevojë të përballet me ‘Republikën e Kosovës’, ka shkruar ajo. Sipas saj, Serbia në këtë marrëveshje nuk ka barë asnjë kompromis. “Të gjitha këto janë arritur pa bërë Serbia asnjë kompromis, ndërkohë pikërisht këtu nxirrte telashe për Serbinë reciprociteti, sepse e përballet direkt me atë që na takon dhe ajo që është normale dhe marrëdhënie e shëndosh bilaterale me



secilin shtet. Nëse Kushtetuta ishte platforma që në mënyrë monotone dhe të zbrazët

përmendej në secilën seancë parlamentare atëherë ku ishte Kushtetuta si platformë

kur u bënë këto pika?! Si gjithmonë, ajo ishte e shkelur”, ka shkruar Haxhiu.

# AKP-ja thotë se nga tërheqja e mjeteve nuk rrezikohen kreditorët

Në kuadër të Ligjit për rimëkëmbje ekonomike është paraparë edhe tërheqja e mjeteve nga "Fondet e mbetura" pas procesit të likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), të cilat do të transferohen në buxhetin e shtetit. Mirëpo, sipas AKP-së, nga kjo tërheqje nuk do të rrezikohet 20-përqindëshi i punëtorëve. Njohësi i çështjeve ekonomike, Safet Gërxhaliu, ka thënë se edhe pse AKP-ja është target i këtyre mjeteve, është për keqardhje se si deputetët nuk e kanë kaluar Ligjin për rimëkëmbje ekonomike para se të shkojnë në pushime. Ndërsa deputeti i PDK-së, Sejdi Hoxha, ka thënë se është çështje e qeverisë të vendosë për mjetet e AKP-së. Pavarësisht kësaj, ai ka thënë se me urgjencë duhet të kalojë ky ligj në Kuvend



**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Qeveria e Kosovës ka paraparë që pakoja për rimëkëmbje ekonomike ta kapë vlerën e 385 milionë eurove, mirëpo ende nuk ka kaluar Ligji për rimëkëmbje ekonomike, pasi deputetët e Kuvendit të Kosovës gjenden në pushim dhe në kuadër të këtij ligji është paraparë edhe bartja e mjeteve nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Kujtojmë se në prill të këtij viti AKP-ja ka bartur në buxhetin e Kosovës 55 milionë euro. Kjo agjenci ka filluar procedurat e transferimit të 55 milionë eurove në buxhetin e shtetit të Kosovës ku, sipas AKP-së, me këtë transferim të mjeteve, shuma e cila është kaluar në buxhetin e Republikës së Kosovës deri në atë kohë ishte 381 734 330 milionë euro.

Kjo është bërë me dije nga një komunikatë për media, ku është thënë se bordi i drejtorëve të AKP-së ka vendosur që 55 015 326 milionë euro të "Fondeve të Përkohshëm" të transferohen në buxhetin e Kosovës. "Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit mbajti mbledhjen e tij të rregullt ku u azhurnua mbi zhvillimet dhe aktivitetet e fundit gjatë muajit mars, ku diskutoi për procesin e privatizimit dhe të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore në përputhje me mandatin e vet ligjor dhe mori vendime të rëndësishme", është thënë në komunikatë.

Mirëpo sipas Agjencisë Kosovare

të Privatizimi (AKP), nga tërheqja e këtyre mjeteve asses nuk do të rrezikohen kreditorët. "Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat të qartë të transformimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe asetëve të tyre përmes një procesi transparent të privatizimit dhe likuidimit të tyre. Në bazë të mandatit ligjor, AKP-ja është e obliguar që të kujdeset për ruajtjen dhe rritjen eventuale të vlerës së asetëve të ndërmarrjeve shoqërore deri në procesin e privatizimit dhe likuidimit, si dhe në kujdesin që duhet të ketë për shpërndarjen e të ardhurave të 20-përqindëshit për ish-punëtorët dhe kreditorët e kualifikuar të ndërmarrjeve shoqërore", është thënë në përgjigjen e Zyrës për Informim të AKP-së dhënë për gazetën "Epoka e re".

Kjo zyrë ka shtuar se "fondet e mbetura pas procesit të likuidimit do të transferohen në buxhetin e Kosovës, ashtu siç kanë bërë deri më tani". "Secila Ndërmarrje Shoqërore (NSH) e transformuar përmes procesit të shitjes/likuidimit, të hyrat nga ky proces mbahen në llogari të veçantë për secilin ish-ndërmarrje shoqërore, duke mundësuar trajtimin e kërkesave të punëtorëve për 20 për qind, kërkesat kreditorë deri në procesin e përmbjlljes së asaj NSH-je. Siç theksuam më lart, vetëm pasi të realizohen pagesat e kërkesave të punëtorëve për 20 për qind, si dhe shqyrtimit dhe përmbjlljes së të gjitha

kërkesave kreditorë, fondet e një NSH-je në likuidim mund të shpallen fonde tepriçë dhe të transferohen në buxhetin e Kosovës, ashtu siç është e përcaktuar me ligjin e AKP-së, pra pa i cenuar të drejtat e punëtorëve për 20 për qind si dhe kërkesat kreditorë", është thënë në përgjigjen e AKP-së. Ndërsa sekretari i përgjithshëm në Forumin Investiv të Odave të Ballkanit Perëndimor WB6 me seli në Itali, Safet Gërxhaliu, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se, edhe pse AKP-ja ishte target i marrjes së mjeteve për rimëkëmbje ekonomike, është për keqardhje moskalimi i Ligjit për rimëkëmbje ekonomike, e që duhet të pritët deri më 15 shtator, kur do ta nisë punën Kuvendi. Ai ka thënë se deputetët e Kuvendit është dashur që ta përfundojnë Ligjin për rimëkëmbje ekonomike, e jo të mendojnë së pari për pushimet e tyre verore. "Kosova është vonuar sa i përket gjetjes së metodave për rimëkëmbje ekonomike qoftë për mbështetje të sektorit privat, qoftë për mbështetje të qytetarëve. Duhet të kemi një angazhim më të mirë në këtë drejtim, pasi nuk mund të jetohej dhe shteti nuk mund të merret vetëm me agenda politike. Besoj se është koha kur duhet të jemi më seriozë në kuadër të Ligjit për rimëkëmbje ekonomike, mirëpo si mund të kërkohet nga mbështetja nga AKP-ja dhe agjencitë e tjera mbështetëse, kur vetë deputetët duhet të jenë në funksion të shtetit dhe jo t'i japin vetes

komoditet që në këtë kohë pandemie dhe krize të shkojnë në pushim dhe ky ligj të presë deri më 15 shtator. Kjo vërtet e dëshmon realitetin e hidhur që në Kosovë mendohet për pushtet dhe jo për shtet. Ata flasin për rimëkëmbje ekonomike, por shumë më tepër u konvenon luksi i tyre sesa të merren me ndihma dhe për gjetjen e mënyrës së ndihmesës për qytetarë dhe për sektorin privat", ka thënë Gërxhaliu, duke shtuar se fondet nga AKP-ja dhe institucionet e tjera duhet të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik. "Është interesant qasja ndaj fondeve të tjera. Në këtë drejtim besoj se AKP-ja duhet të jetë një tragjet dhe prioritet është 20-përqindëshi, pastaj mjetet e tjera të jenë në kuadër të rimëkëmbjes ekonomike. Sot shumë mjete deponohen nëpër institucione të tjera dhe në BQK. Në vend se të shfrytëzohen për rimëkëmbje ekonomike, mbi të gjitha ndaj këtyre fondeve duhet të ketë garanci të transparencës dhe rimëkëmbjes ekonomike. Kosova është vonuar shumë drejt rimëkëmbjes ekonomike", është shprehur ai.

Më herët në një intervistë për gazetën "Epoka e re" deputeti i Kuvendit të Kosovës nga Lëvizja Vetëvendosje dhe kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Transferime, Hekuran Murati, pati thënë se ky projektligj për rimëkëmbje ekonomike nuk e

adreson këtë çështje. "Ky projektligj nuk adreson fare çështjen e rimëkëmbjes. E tëra që mund të gjendet në ato pak faqe që ka ky dokument, është propozimi për t'u mundësuar kontributpaguesve t'i tërheqin 10 për qind të mjeteve të tyre nga Trusti, që në thelb është masë likuiditeti e patargetuar për ndonjë sektor apo industri dhe propozimi tjetër që ka të bëjë me dhënien e mundësisë qeverisë që t'i shpenzojë 100 milionë euro nga fondi i privatizimit, për shpenzime për të cilat nuk e ka autorizimin nga Kuvendi. I vetmi sektor që është trajtuar në këtë projektligj është ai i gastronomisë", pati deklaruar Murati.

Ndërsa deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Sejdi Hoxha, ka thënë se është çështje e qeverisë se si vendos për mjetet e AKP-së. Ai ka apeluar që ligjvënësit t'i kthehen punës para 15 shtatorit dhe të kalohet Ligji për rimëkëmbje ekonomike. "Është çështje e qeverisë se si vendos për mjetet e AKP-së, mirëpo ajo që mund të them unë është se janë vonuar shumë sa i përket planit për rimëkëmbje ekonomike. Më shumë se 6 muaj u është dashur që ta implementojnë vetëm pakon e parë fiskale. Tani me urgjencë duhet të aprovohet Ligji për rimëkëmbje ekonomike dhe qeveria duhet ta ketë prioritet kryesor këtë ligj", është shprehur Hoxha.

## Ngordhin 30 krerë dele nga 'gjuha e kaltër' në Kosovë

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Përveç pandemisë me Covid-19, Kosova është duke u ballafaquar edhe me sëmundjen e kafshëve e cila njihet si "gjuha e kaltër". Si pasojë e kësaj sëmundjeje kanë ngordhur 30 krerë të deleve, ndërsa me raste pozitive vazhdojmë të jenë 15 ferma. Kështu ka bërë me dije zëdhënësi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Lamir Thaçi. Thaçi ka theksuar se autoritetet lokale duhet t'i dezinfektojnë fermat e prekura nga sëmundja "gjuha e kaltër". "Ne i kemi rreth 15 ferma të cilat kanë rezultuar pozitive me 'gjuhën e kaltër'. Po ashtu, këto

ferma janë duke u mbikëqyrë nga inspektorët veterinarë dhe veterinarët e kontraktuar privatë në terren janë duke i kryer mjekimet dhe secila kafshë e cila nuk është shumë me gjendje të rënduar shëndetësore do të mjekohet dhe do ta kalojë sëmundjen. Po ashtu, janë urdhëruar të gjithë fermerët që ta kryejnë dezinfektimin dhe masat e mundshme parandaluese duke e ditur se si sëmundje përhapet përmes mushkonjave "kolikoidus", ka thënë ai për "Ksp". Sipas Thaçit, komunat tashmë janë të obliguara që t'i caktojnë



lokacionet për groposjen e kafshëve të cilat mund të ngordhin nga kjo sëmundje.

"Tani për tani raste pozitive kemi në Komunën e Vushtrrisë, Komunën e Shtërpçës dhe disa

komuna të tjera që janë brezin kufitar me Maqedoninë dhe të gjitha janë të monitoruara nga inspektorët dhe numri deri më tani i ngordhjeve është i vogël duke e ditur se niveli i ngordhshmërisë që shkakton kjo sëmundje është i lartë, por deri më tani i kemi vetëm rreth 30 krerë dele të raportuara si të ngordhura. Dhe ne po besojmë që me ndryshimin e temperaturave shumë shpejt do ta kalojmë sëmundjen", është shprehur Thaçi. Kujtojmë se sëmundja e kafshëve "gjuha e kaltër" ka qenë e përhapur në vendin tonë edhe në vitin 2015.



# 'Serbia nuk mund ta shfrytëzojë Ujmanin, ai është i dedikuar për nevoja të Kosovës'



PRISHTINË, 6 SHTATOR - Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar marrëveshje për normalizim ekonomik në Shtëpinë e Bardhë, në kuadër të së cilës, bashkë me amerikanët, parashihet hartimi i një studimi të fizibilitetit me qëllim të përdorimit të përbashkët të Liqenit të Ujmanit, si furnizues i sigurt i ujit dhe energjisë. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në Shtëpinë e Bardhë më 4 shtator. Liqeni i Ujmanit është më i madhi në Kosovë, i cili shtrihet në veri-perëndim të vendit, konkretisht në Komunën e Zubin Potokut, komunë kjo e banuar me shumicë serbe. Ky liqen ka sipërfaqe prej 11.9 kilometrash katrorë (nga të cilat 9.2 kilometra katrorë në territorin e Kosovës dhe 2.7 kilometra në territorin e Serbisë) dhe 370 milionë kub ujë. Penda e Ujmanit është ndërtuar midis viteve 1970-1984. Hidrocentrali prodhon 35 megavatë për orë

energji elektrike, kurse kanali Ibër-Lepenc është 49 kilometra i gjatë dhe është ndërtuar me fonde të buxhetit të Kosovës. Kanali Ibër - Lepenci kalon nëpër territorin e pesë komunave - Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtri, Obiliq, Prishtinë, duke kaluar nëpër 33 vendbanime rurale dhe dy qytete.

Ky liqe menaxhohet nga ndërmarrja hidroekonomike "Ibër-Lepenc" me seli në Prishtinë, në pronësi të Qeverisë së Kosovës. Kryeshefi ekzekutiv i kësaj ndërmarrjeje, Berat Lushtaku, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se Liqeni i Ujmanit është në pronësi të Ibër-Lepencit edhe në pjesën e Kosovës dhe pjesën e Republikës dhe për këtë, thotë ai, ekzistojnë dokumentet e nevojshme. "Ne do t'i marrim të gjitha vendimet me bordin e drejtorëve dhe do të dalim me një konkluzion konkret sa i përket kësaj çështjeje. Aksionar 100 për qind është Qeveria e

Republikës së Kosovës dhe ajo i ka të drejtat mbi ne", ka thënë Lushtaku.

Ky liqe artificial furnizon me ujë të pijshëm ujësjellësin e Mitrovicës dhe atë të Prishtinës. Kurse me ujë të papërpunuar, ka thënë Lushtaku, furnizon Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) dhe kompaninë "NewCo Ferronikeli", që gjendet në Drenas, si dhe për ujitje në disa rajone të Kosovës.

Ndryshe, pjesëmarrësit në ekipin e ndërtimit të këtij liqeni, e quajnë absurde marrëveshjen, ku thuhet për "përdorim të përbashkët të Liqenit". Halim Gjergjizi, i cili ka qenë pjesë e projektit në vitet '70, thotë se ky projekt në atë kohë është ndërtuar me kredi nga Banka Botërore, për të cilën ka garantuar shteti i ish-Jugosllavisë, kurse obligimet dhe marrëveshjet i kanë nënshkruar njësitë federale, në këtë rast Kosova. Ai ka thënë se liqeni është ndërtuar për nevojat e qytetarëve të Kosovës. "Është

absurde që paraqitet edhe një palë tjetër, çfarë është Serbia. Me gjithë dokumentet, gjithë historinë e ndërtimit të atij kapaciteti, Serbia nuk ka kurrfarë të drejte të shfrytëzimit ose të menaxhimit të atij sistemi. Ndoshta do të ketë sqarime më vonë lidhur me këtë marrëveshje, por tash për tash është absurde. Uji nuk mund të shkojë në Serbi për shfrytëzim. Serbia nuk mund të shfrytëzojë ujin në mënyrë të përbashkët. Ai është i dedikuar për nevoja të Kosovës", ka thënë Gjergjizi për "Radion Evropa e Lirë". Sa i përket Liqenit të Ujmanit, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, në një konferencë për media nga Uashingtoni tha se janë pajtuar që të bëhet një studim i fizibilitetit nga Departamenti i Energjisë të ShBA-së për këtë liqe. "Pra, Departamenti për Energji i ShBA-së, të bëjë një studim të fizibilitetit për Liqenin e Ujmanit për mënyrën se si do të përdoret uji i këtij liqeni në të ardhmen, si


burim ujitje dhe si burim energjie. Vetëm kaq, kjo është e vërteta sa i përket kësaj çështje", ka thënë Hoti.

Në anën tjetër, në Zubin Potok ka një ndërmarrje në pronësi të Serbisë e cila quhet "Ibar" dhe është themeluar në vitin 2002 dhe që Kosovën e konsideron të paligjshme. Vitet e fundit zyrtarë nga Beogradi insistonin ta përvetësonin këtë liqe, çka është kundërshtuar fuqishëm nga autoritetet zyrtare në Kosovë. Madje më 8 shtator 2018 presidenti i Serbisë, Aleksander Vuçiq, kishte vizituar Liqenin e Ujmanit (Gazivodës), ku kishte thënë se "Ujmani është një liqe shumë me rëndësi si për serbët ashtu edhe për shqiptarët". Andaj, sipas tij, është me rëndësi që të gjendet zgjidhje e pranueshme për të dyja palët. Liqeni i Ujmanit nga Serbia dhe presidenti Vuçiq ishte cilësuar si burim dhe pasuri ekonomike serbe, gjë që kundërshtohet ashpër nga autoritetet në Prishtinë.

## Mbi 300 biznese më pak paraqitën kërkesë për mbyllje se vitin e kaluar

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Gjendja e rëndë e krijuar pas fillimit të pandemisë Covid-19 ka bërë që biznesmenët të mos i mbyllin bizneset me shpresën e rifillimit të aktivitetit dhe përkrahjes nga shteti, e cila nuk është duke ndodhur. Për vitin 2020, kërkesën për shuarje të biznesit e kanë parashtruar 315 biznese më pak sesa në vitin 2019. Kështu të paktën është thënë nga Agjencia për Regjistrim të Bizneseve në Kosovë (ARBK). Sipas kësaj agjencie, aplikimin për shuarje të biznesit në këtë vit e kanë parashtruar 576 biznese krahasuar me vitin 2019, që

ishite 891 biznese vetëm në periudhën janar-korrik. Ndërsa në vitin 2020, në periudhën janar-korrik janë regjistruar 4 436 biznes, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 që ishin 5 106 biznese. "Në vitin 2020, në gjashtëmujorin e parë janë regjistruar gjithsejtë 4 346 biznese. Në vitin 2019, në gjashtëmujorin e parë janë hapur gjithsejtë 5 106 biznese, kurse në vitin 2020 në gjashtëmujorin e parë janë shuar gjithsejtë 576 biznese, ndërsa në vitin 2019 në 6-mujorin e parë janë shuar gjithsejtë 891 biznese", është thënë në përgjigjen me shkrim



nga ARBK-ja për "Kosovapress". Agjencia për Regjistrim të Bizneseve ka thënë se procedurat për hapjen e një

businessi është dy ditë pas parashtrimit të kërkesës këtë agjenci. Në lidhje për këto shifra, eksperti i ekonomisë,

Safet Gërxhaliu, ka thënë se hapja e bizneseve në këtë kohë është një renditje e re. "Shumë njerëz ndoshta e kanë prolonguar dështimin ose mbylljen dhe besoj se deri në fund të vitit do të kemi rezultate shumë më negative, të cilat do ta përshkruajnë një gjendje të mjerueshme ekonomike në Kosovë", ka thënë Gërxhaliu. Ndërsa profesori i ekonomisë, Muhamet Mustafa, ka thënë se pandemia ka ndikuar në mbylljen e bizneseve sepse është rritur pasiguria edhe për bizneset që hapen, por edhe për investime të bizneseve të reja.

# Fillon ndërtimi i fushave të sportit në dy shkollat në Kijevë të Malishevës

**MALISHEVË, 6 SHTATOR (ER)** - Në kuadër të realizimit të projekteve të planifikuara dhe të investimeve kapitale, në fshatin Kijevë të Malishevës ka filluar ndërtimi i fushave të sportit për shkollën fillore si dhe për atë të mesme profesionale. Në fillimin e punimeve ishin të pranishëm drejtori komunal i Arsimit, Blerim Thaçi, ai i Urbanizmit, Ahmet Morina, asamblisti nga Kijeva, Kajtaz Gashi, drejtorë të shkollave përkatëse dhe kryetari i Kijevës, Bashkim Gashi dhe qytetarë të tjerë. Në fillimin e punimeve drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina, ka thënë se, përpos këtyre dy fushave sportive në Kijevë, është duke

u investuar edhe në shumë projekte të tjera, duke përfshirë është zgjerimin e ndriçimit publik. "Së shpejti fillohet ndërtimi i çerdhes, rrugëve të reja dhe shumë projekte tjera", ka thënë Morina. Ndërsa drejtori i Arsimit, Blerim Thaçi, ka thënë se "ndërtimi i fushave sportive për shkollat janë pjesë e investimeve në krijimin e kushteve më të mira për shkollat e Komunës së Malishevës, përfshi edhe fushat sportive". Në anën tjetër, kryetari i Kijevës, Bashkim Gashi, e ka falënderuar Komunën e Malishevës për këtë investim si dhe për investimet e tjera që pritet të fillojnë së shpejti.



## Kërkohe ruajtja e ambientit në Skenderaj

**SKENDERAJ, 6 SHTATOR (ER)** - Drejtorja e Shërbimeve Publike në Skenderaj, bashkë me kompaninë "Uniteti", pas eliminimit të 106 deponive ilegale muaj me parë, gjatë javës që e lamë pas ka larguar edhe dy deponi të tjera, njërin të "Lagjja 3" e qytetit dhe tjetrën në Burojë, të rruga "Mulla Ilaz Buroja". Me këtë rast, kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka apeluar te qytetarët që mbrojnë mjedisin. Jashari ka thënë se janë në rrugë të mbarë për të ndërtuar një qytet të zhvilluar dhe të pastër. "Duke u kujdesur për natyrën ne kujdesemi për shëndetin tonë. Aplikimi i gjobave kundër atyre që ndotin mjedisin nuk është dëshirë e jona, por nganjëherë mjet i domosdoshëm i vetëdijesimit qytetar", ka thënë Jashari. Më tutje, Jashari ka kërkuar nga qytetarët e Skenderajt që të mos hedhin mbeturina jashtë vendeve të caktuara dhe lajmërojnë tek organet komunale të gjithë ata që ndotin mjedisin.



## Komuna e Kamenicës pranon donacion për mbrojtje nga Covidi



**KAMENICË, 6 SHTATOR (ER)** - Shoqata Humanitare "Al Hidayah" dhe "Dora e djathtë" kanë dhuruar gjashtë mijë maska për të rritur, tre mijë për fëmijë në Kamenicë dhe 100 dezinfektues. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka falënderuar shoqatat për donacionin e dhuruar gjatë kësaj periudhe të pandemisë. "Falënderoj për këtë donacion Shoqatën Humanitare 'Al Hidayah' dhe 'Dora e djathtë' jam shumë mirënjohës për kontributin që të gjithë po japin për Kamenicën në këtë kohë të pandemisë", ka thënë Kastrati.

## Nis asfaltimi i rrugëve në fshatin Jezerc të Ferizajt

**FERIZAJ, 6 SHTATOR (ER)** - Komuna e Ferizajt ka bërë me dije se projektet infrastrukturore në këtë komunë janë duke u realizuar me intensitet të shtuar. Në këtë kontekst, kjo komunë ka theksuar se fshati më i madh në territorin e Ferizajt, Jezerc është shndërruar në kantier punimesh në rregullimin e infrastrukturës rrugore. "Ka nisur realizimi i projektit për asfaltimin e 31 kilometrave rrugë në zonën turistike të Jezercit që, përveç ndikimit ekonomiko-turistik për Ferizaj, ka edhe rëndësinë historike dhe vlerat natyrore që përfaqëson", ka njoftuar Komuna e Ferizajt. Për t'i parë nga afër punimet në këtë projekt, ka dalë në terren kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, bashkë me drejtorë të drejtorive komunale. Ai ka thënë se me realizimin e këtij projekti kompletëhet infrastruktura rrugore në këtë fshat.

"Qeverisjet që ne kemi udhëhequr vazhdueshëm kanë qenë të kujdesshme për një vend kaq të rëndësishëm dhe me kaq histori siç është fshati Jezerc. Edhe në periudha kur ne kemi qeverisur janë bërë investime shumë të rëndësishme dhe ju e dini që tashmë janë përfunduar dy akse rrugore tepër të rëndësishme, njëra prej tyre madje e lidh edhe Komunën e Ferizajt me Komunën e Therandës përmes këtij aksi, por tashmë ky projekt e shton vlerën e Jezercit sepse praktikisht bashkon këto dy akse rrugore dhe përfshinë të gjitha rrugët që e kanë pjesë në territorin e fshatit Jezerc. Dihet se fshati Jezerc edhe me territor është fshati më i madh në Komunën e Ferizajt. Jemi shumë të lumtur, shumë të kënaqur që po e fillojmë këtë projekt tepër të rëndësishëm për Jezercin", ka thënë Aliu.



# FRENOJENI ARROGANCËN ZOTI GRENELL, NUK JEMI TË GJITHË VEGJETARIANË POLITIKË!



Shkruan: Behxhet  
Sh. SHALA - BAJGORA

Marrëveshje jo e keqe, por më shumë se e keqe: Është dashur të jeni shumë naivë jo vetëm politikisht e të besoni se në Uashington do të bisedohet e madje edhe të nënshkruhet marrëveshja përfundimtare me Serbinë për normalizim të marrëdhënieve dhe njohje reciproke me anëtarësim të menjëhershëm në OKB dhe organizata të tjera. Avdullah Hoti, kryeministër i Kosovës, dha zotime publike se me Serbinë do të bisedojë vetëm për njohje reciproke, e që këtyre fjalëve nuk i besoi as vetë e lëre më të tjerët. Kryeministri i Kosovës edhe më herët kishte mungesë të theksuar të karizmës. Tani na bindi se ka mungesë edhe më të madhe të koqizmes për procese të mëdha ku kërkohet guxim në vendimmarrjen politike. As që u diskutua në Uashington për njohje reciproke, madje as në korridore ku bën politikë liga e dytë politike. Tash po del, sipas arrogancës Grenell, se ShBA-ja nuk ka nënshkruar kurrfarë marrëveshje me Kosovën sikur që kriminelit i luftës, Ivica Daçiq, po deklaroi se kriminelit i luftës më i madh se ai, Aleksandër Vuçiq, nuk ka nënshtruar asgjë me Kosovën. Disi po del sikur të jetë simuluar për publik nënshkrimi i një marrëveshjeje të cilën po e quajnë historike, në një mjedis thuaja histerik. Tash, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti po thotë se nënshkrimi i marrëveshjes për njohje reciproke është synim i kryeministrit dhe se kjo do të arrihet brenda një viti e që i ngjanë të flasim për borën e vitit të kaluar sa i përket sigurisë së mbajtjes së premtimit. Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës për faktin se faktori ndërkombehtar nuk ushtron asnjë presion në këtë drejtim dhe ne, jo që nuk kemi qenë në gjendje të imponohemi përballë Serbisë në këtë

drejtim por, madje me veprimet tona seriozisht e kemi rrezikuar Kosovën si shtet. Kosova nuk duhet kurrë të insistojë që Serbia të na njeh si shtet, por ne duhet të funksionojmë si shtet sidomos përballë Serbisë. Po e them me bindjen më të thellë se Serbia do ta njeh pavarësinë e Kosovës vetëm në rast se Kosova do të katandiset në atë gjendje që nuk i duhet as qytetarëve të saj. Për këtë edhe po angazhohet. Presidenti Trump e bëri një veprim shumë të pandershëm kur deklaroi se Kosova me shumicë myslimane po e hapë Ambasadën në Jerusalem. Në këtë mënyrë aspak nuk dallon nga deklarimet e Serbisë se Kosova është vend i fundamentalizmit islamik. Kosova është shtet me shumicë absolute shqiptare që brendapërbrenda bashkëjetojnë të gjitha besimet (shqiptare) dhe se përcaktimi i besimit kurrë nuk ka qenë para identitetit kombëtar. Trumpi nuk tha se një vend me shumicë të besimit ortodoks, Serbia, do të hapë Ambasadën në Jerusalem. Kjo marrëveshje, e nënshkruar apo e simuluar është përmbledhje e marrëveshjeve të mëparshme plus, Trump, për nevoja elektorale i fut disa gjëra që aspak dhe asgjë nuk kanë të përbashkët me një marrëveshje ekonomike. Çka hynë në punë për normalizim ekonomik midis Serbisë dhe Kosovës, njohja nga Izraeli dhe hapja e Ambasadës në Jerusalem?! Apo çështja e Hezbollahut që nuk ka të bëjë asgjë me Marrëveshjen për normalizim të marrëdhënieve ekonomike midis Kosovës dhe Serbisë. Sikur edhe "5G" që në fakt është luftë midis Trump dhe Kinës për të eliminuar "Huawein". Ndikim ekonomik i Kinës dhe Rusisë si edhe vendeve arabe në Serbi është shumë më i madh se ai amerikan. Serbia e ka futë në tregun serb "Ericsonin" dhe sa do të ndikojë Marrëveshja e Uashingtonit? Kjo marrëveshje Serbinë e bënë bashkëpronare në shumë procese në Kosovë, e forcon Kishën Ortodokse serbe duke e vënë mbi shtetin dhe ligjet e Kosovës dhe vetëm nuk e përmend në marrëveshje Otac

Savën dhe Manastirin e Deçanit. Aspak nuk qëndron fakti se me këtë marrëveshje pengohet ndarja e Ujmanit, por se i kanë shtuar një formulim mashtrues, fizibilitet për ndarje dhe shfrytëzim të ujërave të Ujmanit për energji dhe nevoja tjera..... Serbia e ka të garantuar portin në Durrës apo Shëngjinin përmes Kosovës. Me një fjalë, Serbia është fituese absolute për faktin se është diskutuar dhe nënshkruar marrëveshja që ka të bëjë vetëm me përfitimet e Serbisë në Kosovë duke krijuar raporte të varësisë ekonomike. Edhe Kosova, si pula qorre do ta gjejë aty -këtu ndonjë kokërr interesi, asgjë më tepër. Mungesa e moralit elementar: Në jetën e përditshme, për çdo gjë që e bëni duhet të keni disa parime, qofshin ato edhe elementare. Edhe në politikë, veprimtaria e së cilës në shumë raste dhunon parimet morale duhet të ruani një minimum të standardit moral. E sidomos ne që çdo të dytën fjalë e kemi moralin kurse të parën patriotizmin. Para disa muajve, Blerim Reka, si holandezi shëtitës u emërua ministër për Integritet Evropian në qeverinë Kurti. Në një prononcim për media foli për një korridor që i duhet Serbisë për dalje në det e që do të ishte kompromisi që do e bënte Kosova. Nuk mbeti kush pa reaguari kundër tij duke kërkuar dorëheqjen e tij dhe duke e krahasuar edhe me Garashaninin, Andriqin, Pashiqin dhe Sllobodan Millosheviqin. Në skuadrën për pushkatim moral, politik dhe kombëtar kishte të tillë që Marrëveshjen e Uashingtonit e cila tërë Kosovën e bënë territor të hapur për Serbinë për dalje në det, lumenj, male, fusha, rrugë, liqene dhe ku të dojë Serbia, e quajnë historike dhe jashtëzakonisht të dobishme për Kosovën. Edhe unë, si vrojtues i këtij pushkatimi të Blerim Rekës e shkrepja një plumb virtual kur e krahasoj atë që e tha Blerimi me këtë që shkruan në Marrëveshjen e Uashingtonit e pranoj se Blerimi është beninj në krahasim me kancerin malinj të Hotit. Për propozimin e Edi Ramës për minishengenin ballkanik, Ramën jo vetëm që e shpallën

tradhtar dhe vëlla të Vuçiqit por kërkonin t'i sigurohet një vend për varr afër Esad Pashë Toptanit. Patriotët e Leshit dhe kurvat politike të Kurveleshit. Po të kishin vetëm pakëz moral njerëzor dhe politik, do të duhej të kërkonin falje publike. Sidomos për minishengenin për të cilin kryeministri Avdullah Hoti e pati bërë një kundërshtim të detajuar sikur që Balzaku përshkruante në hollësi krevatin e tij ku frekuentonin shumë zonja dhe kurtizane të Parisit të asaj kohe. Të gjithë ata që e kanë kritikuar propozimin e Rekës për korridor për Serbinë dhe minishengenin e Ramës që e glorifikojnë deri në orgazëm Marrëveshjen e Uashingtonit, do të ishin klientelë e mrekullueshme për Balzakun. Zoti Grenell, njerëzit dallojnë, mësohuni me këtë: Riçard Grenell është arrogant dhe agresiv ndaj të gjithë atyre që nuk mendojnë si ai. I kërcënon publikisht dhe demonstroi muskuj, jo në formë të trurit por në formë të shklopit të bejzbollit. Kur Ramush Haradinaj nuk u pajtua me nënshkrimin e Marrëveshjes, ai kërcënoi me sanksione. Kur kryetarja e Kuvendit, zonja Vjosa Osmani i reagoi kryeministrit Hoti se nuk i qëndroi zotimit publik, pa u fërkuar fare me Grenellin, ky me arrogancën e dëshmuar dhe demonstrim të forcës e kundërshtoi, pa të drejtë zonjën Osmani duke dhunuar në këtë mënyrë parimet dhe vlerat mbi të cilat është ndërtaur shteti dhe demokracia amerikane, respektimi i fjalës së lirë dhe lirisë së shprehjes. Nuk është hera e parë që z. Grenell tregohet dhunues ndaj fjalës së lirë. Në fakt, z. Grenell kërkon mirëkuptim për komunitetin që i takon ndërkaq, në anën tjetër nuk tregohet mirëkuptues ndaj mendimit ndryshe sikur në rastin e kryetares së Kuvendit. As unë nuk pajtohem se Marrëveshja e Uashingtonit është më e mira për Kosovën dhe historike, madje mendoj se është shumë e keqe. Në një mjedis demokratik dallimet në mendime i shtojnë sharmin kurse në një autokraci që e zbaton Grenelli ndaj kosovarëve, ndaj serbëve është shumë butak,

demokracia është në shtratin e vdekjes. Deri më tani Grenelli është përballur vetëm me yesmena apo, sikur në Uashington me një pjesë të adoleshencës së hershme politike të Kosovës që nuk iu intereson fare përmbajtja por vetëm efektet e fejsbukut. Një fotografi e përbashkët me Grenellin për ta bërë pjesë e ADN-së politike dhe trashëgimi për disa breza familjarë. Mund të kërcet edhe ndonjë këngë! Është joserioze të deklarohet se kemi bërë lëshime vetëm shkak i amerikanëve ndërsa i kritikoni dhe ndërtoni karrierë mbi lëshimet e paraardhësve tuaj politik. Apo, e injorova Vuçiqin se foli serbisht. Mos keni prituri të flas në gjuhën mandarine! Xhevahir pas xhevahiri, por të gjithë të shtrirë para këmbëve të Grenellit. Ekipet negociuese të Kosovës po ndërrohen shpesh, nuk kanë strategji e as dije për t'u përballur me probleme politike dhe as që kanë kapacitet negociues. Para Grenellit dhe Borrellit bëhen pleshta, para nesh dhe midis nesh sillen si elefantë. Prandaj pranojnë çdo gjë që iu serviret në pjetën e bisedimeve në Uashington (sidomos) por edhe në Bruksel. Përralla janë premtimet se do të investohen 13 miliardë dollarë. Kosova është shndërruar në një kuti votuese për zotin Trump, me rezultate të trukuara. Trumpi e futi në lojë Izraelin, me pajtimin e Serbisë. Kur u fol se Kosovën do ta njeh një shtet shumë i fuqishëm, mendova se janë Kina, Rusia apo India. Kjo marrëveshje, me këtë përmbajtje, pa formë dhe pa adresë të përgjegjësive, vështrirë të jetë e zbatueshme. Opozita në Kosovë e kundërshtoi disi në formë hezituese. Pozita, e nënshtruar dhe me të vetmin problem mbijetesën politike, që e ka prioritet kryesor, nuk e ka frikën sepse nuk ratifikohet në Kuvend. Ka hyrë në itinerarin e udhëtimeve politike Uashington - Bruksel, me parametra zero të rrezikut, deri në momentin kur duhet të kundërshtojnë pasi të përballen me realitetin. Nëse atëherë nuk do të bëhet vonë. A ka më mirë nëse do të gaboja në parashikimin tim!



Flet akademik Muhamedin Kullashi (4)

# Filozofia dhe drama



Intervistoi: Prof. dr.  
Haqif Mulliqi

Muhamedin Kullashi është intelektual *par excellence*. Është kënaqësi e madhe që të bisedosh me të dhe të përballësh me elokuencën dhe poliedrizmin e tij. Është akademik. Disa vjet ka qenë profesor në Universitetin "Paris 8" në Francë. Është filozof i shquar, vlerësimet për të cilin janë bërë edhe jashtë hapësirave tona. Profesor Kullashi është autor i një numri të madh të veprave nga fusha e filozofisë e që, sipas mendimit tonë, janë libra që ngërthejnë në vete: filozofinë, sociologjinë, ontologjinë, antropologjinë, teorinë e artit dhe poetikën e tij. Krahas angazhimeve si profesor i njërit prej universiteteve më të njohur në botë, atij "Paris 8", profesor Kullashi kontribut të jashtëzakonshëm ka dhënë edhe për zhvillimin e filozofisë në Universitetin e Prishtinës. Ajo që na ka mahnitur gjithmonë është se Muhamedin Kullashi është edhe njohës i pasqorë i fushës së dramaturgjisë dhe teatrit. Titujt e librave të tij janë të shumtë dhe, prej rreth katër dekadash, si rrallëkujt, veprat e tij janë botuar edhe në gjuhën frënge. Profesor

Kullashi disa vite ka shërbyer edhe ambasador i parë fuqplotë i Republikës së Kosovës në Francë. Këtë intervistë me të e kemi realizuar për revistën për letërsi, kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia".

*Po shkrimet dhe botimet nga fusha e filozofisë në Francë?*

**KULLASHI:** Qëndrimi në Paris, gjatë tridhjetë viteve në vijimësi, ma ka ofruar mundësinë, krahas ligjërimit nga fusha e filozofisë, të shkruaj dhe të botoj jo vetëm në Francë, por edhe në Belgjikë, Itali, Spanjë, Kanada, Uruguai dhe në disa vende frankofone të Afrikës. Përveç botimit të librave të mi, një pjesë e konsiderueshme e këtyre shkrimeve është botuar, në gjuhë të ndryshme, në botime me grup autorësh (francezë, belgë, italianë, gjermanë etj.) Pjesa më e madhe e këtyre shkrimeve i takojnë fushës së filozofisë politike, e një pjesë e rëndësishme e tyre trajton çështje të ndryshme për shpërbërjen e ish-Jugosllavisë dhe konfliktet brenda saj. Këto tekste në veçanti trajtojnë aspekte të ndryshme të çështjes së Kosovës, që kapin një periudhë së paku njëzetvjeçare, përfshirë edhe perceptimet dhe qëndrimet që janë zhvilluar lidhur me Kosovën gjatë kësaj periudhe, brenda shoqërisë civile, klasës politike dhe mediave të disa vendeve perëndimore.

Do ta veçoja këtu një botim të rëndësishëm të UNESCO-s, në gjuhën franceze dhe në gjuhën angleze, që doli në vitin e fundit të shekullit XX. Për mua ishte nder i veçantë që sekretari i

përgjithshëm i UNESCO-s, Fédérico Mayor dhe filozofi Roger-Pol Droit, më ftuan të marr pjesë në këtë botim, me titullin *Letra brezave të ardhshme*. Për t'i prezantuar ngjarjet e Kosovës, shkaqet e saj, kam zgjedhur një prosede të cilin e kanë kultivuar në veçanti disa filozofë francezë të shekullit XVIII: Montesquieu në *Letrat persiane* dhe Diderot në disa nga dialogët e vet filozofikë: kryqëzimin e shkrimeve dhe pikëpamjeve të disa "personazheve" për disa çështje të rëndësishme. Autorë nga fusha e filozofisë në këtë botim ishin edhe Richard Rorti (ShBA), Remo Bodei (Itali), Fernando Savater (Spanjë), Darius Shayegan (Iran), Leopoldo Zea (Meksikë), Tanella Boni (Bregu i Fildisht). Kurse nga fusha e letërsisë shkruajnë Nadine Gordimer (Afrika e Jugut), dhe Tahar Ben Jelloun (Marok).

*Profesor, teatri varet nga vendi dhe hapësira, jo vetëm si kategori narrative, ngaqë nuk ekziston një tregim që nuk u shkrua dhe nuk u shpalos në to. Pse, në një vazhdimësi disa mijëvjeçare, nuk reshti asnjëherë interesimi i filozofëve për dramën dhe për teatrin?*

**KULLASHI:** Filozofia evropiane ka kultivuar, gjatë gjithë historisë së saj, raporte të ngushta me artin teatror. Koha e lulëzimit të teatrit në Greqinë antike, siç e dini, gërshetohet ngushtazi me zhvillimin e hovshëm të mendimit filozofik, me parasokratikët dhe me Platonin e Aristotelin në veçanti. Vepra e

Aristotelit *Poetika* u bë tekst themeltar jo vetëm për zhanrin e tragjedisë, por edhe si përsiatje vendimtare për artin e teatrit, me diversitetin e zhanreve të tij. Lidhshmëritë e ngushta të filozofisë me teatrin u realizuan gjatë shekujve edhe në saje të faktit se filozofë të mëdhenj, të epokave të ndryshme ishin, po ashtu, edhe autorë të veprave teatrorë: në antikitetin greko-romak (Seneka etj.), në rilindje (Makiaveli, etj.), në modernitet (Diderot, Voltaire etj.), në bashkëkohësi (Sartre, Camus etj.). Një aspekt i këtij gërshetimi të ngushtë u shpërfaq me lindjen e *estetikës* si disiplinë filozofike mbi artin. Në fakt, fjala teatër etimologjikisht do të thotë "vend nga i cili shikohet" ngaqë folja greke *theaomai* thotë të shikosh, të soditësh. Brenda etimologjisë së fjalës, kësisoj, është ruajtur lidhja midis filozofisë dhe teatrit. Mirëpo, një aspekt i veçantë i kësaj ndërlidhjeje shfaqet edhe me shprehjen që e inauguroi Shakespeare me *theatrum mundi*, bota si teatër. Diversiteti semantik dhe shumësia e fushave teorike dhe praktike e *topos-it* të *theatrum mundi* vazhdojnë të hulumtohen, siç e thotë, nga filozofët dhe kritikët e teatrit edhe në periudhën bashkëkohore. Këta nxjerrin në shesh originën e moçme të kësaj formule në saje të përsiatjeve mbi modelet e ndryshme të përfytyrimit të botës. Teatri evropian, që nga tragjedia dhe komedia greke e romake deri te format dramatike moderne dhe bashkëkohore, vë në pah se

"hapësira teatrale është një shkurtesë e botës, kurse teatri që aty shpaloset, si reflektim apo rikrijim i një bote të perceptuar si lojë, komedi apo shfaqje, nën shikimin e zotave politeistë, e Zotit monoteist, ose e njerëzve" (Catherine Treilhou-Balauzé). Kësisoj, një nga simpoziumet kushtuar kategorisë *theatrum mundi*, në Paris, më 2007, thekson se dëshiron të jetë "udhëkryq i përfytyrimeve filozofike dhe teatrorë të *theatrum mundi* dhe si një vend i vrojtimit të aksionit të ndërsjellë të mendimit mbi praktikën teatrale dhe e teatrit si ushtrim i të menduarit filozofik". Për mua ngashënjimi nga arti teatror vinte nga leximi i veprave teatrorë: në radhë të parë, i tragjedive klasike greke (Sofokliut, Eskilit e Euripidit) dhe tragjedive të kohës klasiciste (Shakepsareit, Racineit dhe Corneilleit), por edhe të komedive të Molierit. (Zaten, Goethe shkruan se kur i lexonte disa komedi të Molierit absorbohej aq shumë prej tyre sa nuk mund të shkruante ato ditë.) Ngashënjimin nga leximi i këtyre veprave e shtonte edhe të shikuarit e atyre veprave në skenat e teatrove të Zagrebit (HNK, ITD, Gradsko Kazaliste). Më kanë mbetur në kujtim të paharrueshëm disa shfaqje nga ato vite, mes tyre shfaqja *Apologjia e Sokratit* nga Platoni, me rolin kryesor të aktorit të madh Pero Kvirgic. Njëherazi në Institutin francez në Zagreb gjatë studimeve huazoja disqe me poezi dhe pjesë teatrorë, klasike dhe bashkëkohore, të interpre-

tuara nga aktorë të mëdhenj francezë. Kjo etje për artin teatror vetëm sa u shtua në Paris, me frekuentimin e teatrove të ndryshme.

### Pikëpamja e Platonit

*Profesor, jeni një prej njohësve më të mirë shqiptarë që kam takuar, të dramës dhe të teatrit në përgjithësi. Ndaj propozoj të ndalojmë pak te lidhja e tyre me filozofinë. Këto lidhje janë të pandashme. Pse mendoni të ketë ndodhur kjo? Në fakt, drama dhe teatri as që mund të paramendohen jashtë “çatisë” së filozofisë. Idealizmi i Platonit, poetika e Aristotelit, teoritë e Hegelit dhe të Kantit mbi tragjedinë, teoritë e Hajdegerit për dramën dhe teatrin e deri te teatri i angazhuar...*

**KULLASHI:** Kritika e Platonit mbi artin mimetik (imitues) në përgjithësi, dhe e teatrit, në veçanti, ka ushtruar ndikim te teoritë mbi teatrin, jo vetëm në antikitetin greko-romak e mesjetë, por edhe më tutje, në modernitet, ndonëse ka pësuar transformime të theksuara brenda rrymave të ndryshme të artit teatror. Kjo kritikë, paradoksalisht, u shpaloj në kohën e shpërthimit të një krijimtarie të artit teatror (me Eskilin, Euripidin e Sofokliun, veç të tjerëve) nga më të begatshmet në histori. Platon i bën vërejtje teatrit, fjala vjen, se praktikon formën e skajshme të imitimit, ngaqë imituesi (poeti-aktor) bëhet aty vetë në qenien e tij i ngjashëm me atë që imiton. Ai kritikon teatrin ngaqë e shikon si një aktivitet “i ndarë nga realiteti”, e sidomos pse e bën ngatërrimin e personaliteteve (autori, aktori, spektatori). Por, imitimi teatral, për të, mbështetet në një konfuzion më të thellë e më të rëndë ngaqë na shpie ta konsiderojmë aparençën si realitet. Ndërkaq, për koncepcionin metafizik të Platonit ndarja midis aparençave (dukjeve) dhe realitetit është ndarje midis asaj që është e sipërfaqshme, iluzore, e pavërtetë dhe asaj që është e vërtetë dhe e mirëfilltë. M. Haumesser, filozof dhe aktor, në librin e vet *Filozofi e teatrit* thekson se teatri, sipas Platonit, kënaq dhe ushqen prirjen tonë të çuditshme që t’u besojmë aparençave, që është një “dobësi e natyrës sonë”, e cila na shpie të besojmë te ngjarjet dhe te gjërat që nuk kanë vërtetësi. Poezia mimetike përjashtohet nga sfera e njohjes së mirëfilltë të botës, njohjes racionale, prandaj

edhe është vetëm njohje e sipërfaqshme, *simulim* i njohjes së vërtetë. Edhe përmbajtja e aksioneve, në një shfaqje teatrale, meqë mbështetet te aparençat, ka të bëjë me lajka ndaj sensibilitetit tonë. Karakteri i shumëfishhtë i imitimit mbetet thjesht në nivelin e aparençës së ndjeshme (sensibile) dhe dështon të arrijë te natyra dhe thelbi i një gjëje. Mu për këtë, teatri del te Platonit si një instrument i “shpërbërjes së shpirtit” ngaqë i dorëzohet “diversitetit të aparençave”, të asaj që është e sipërfaqshme dhe e pavërtetë. Mirëpo, Platonit në disa tekste të tjera (*Fedri*) vë në pah fuqinë e poezisë, e cila përshkon çdo art që ta vendosë të vërtetën brenda rrezatimit të së bukurës. Ndërkaq Aristoteli, ndryshe nga Platonit që i kritikon aparençat te *Poetika*, do ta kërkojë të vërtetën e teatrit pikërisht brenda aparençave, brenda ndryshimëve të tyre. Ai do të ushtronte ndikim te disa rryma të tjera të mendimit dhe artit teatror në shekujt që vijojnë. Aristoteli, në fakt, tematizon jo imitimin e një ideali, por aksionin brenda ndryshimëve të rrethanave e, sidomos, transformimet e karaktereve dhe të mendimeve të personazheve. Peter Szondi, kritik bashkëkohor i teatrit, bën dallimin midis “poetikës së tragjedisë” ashtu si zhvillohet duke filluar nga Aristoteli dhe, në anën tjetër, “filozofisë së tragjikes”, që paraqitet kryesisht brenda filozofisë klasike gjermane: te Schelling (Shelling), Schopenhauer (Shopenhauer) dhe Nietzsche (Niçe), megjithatë dallimet e mëdha midis tyre në të kuptuarit e asaj që është tragjike. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX filozofët Kierkegaard dhe Nietzsche do t’i problematizojnë rrënjësisht pikëpamjet e Platonit dhe Aristotelit mbi teatrin.

*Edhe pse, ndonjëherë, kishte tendenca që kjo marrëdhënie të ndryshonte, me përpjekjet e tyre që ta ndryshojnë traditën e gjatë të Aristotelit mbi unitetin e vendit, kohës dhe të hapësirës (krijimi i të ashtuquajturit teatër i përqeshjes), megjithatë lënda primare e interesimit në përgjithësi nuk ndryshoi në dramë, përgjithësisht. A do të thotë kjo se njerëzit janë mësuar me këtë traditë dhe nuk janë të prirë të eksperimentojnë apo, filozofia dhe filozofët i kanë ofruar dramës dhe teatrit formulën më funksionale për të funksionuar dhe për t’u zhvilluar?*

**KULLASHI:** Peter Szondi, fjala vjen, si kritik favorizon para-

digmën aristotel-hegeliane, duke mbrojtur një pikëpamje, e cila, krahas pranimet të ndryshimeve që pëson drama moderne si në mbarim të shekullit XIX, po ashtu edhe gjatë shekullit XX, afirmojnë një vazhdimësi. Ndërkaq Hans Lehmanni zhvillon një interpretim të filozofisë së Hegelit mbi dramën e cili ka për qëllim ta mbështesë koncepcionin e tij mbi teatrin postdramatik dhe që nënkupton ndarjen midis teatrit dhe dramës, si dy bota të ndryshme, pastaj edhe shuarjen dhe vdekjen e dramës. Brenda këtij ballafaqimi të interpretimeve mbi dramën moderne mendoj se Sarrazac ofron një koncepcion më kompleks mbi kthesën e dramës moderne, pikërisht duke zhvilluar një kritikë të thukët të paradigmës aristotel-hegeliane mbi dramën, njëherësh edhe kompleksitetin e transformimeve të dramës, që nisin me Ibsenin e Strindbergun e pastaj thellohen dhe begatohen në shekullin XX.

### Sistemi filozofik i Hegelit në përgjithësi dhe teoritë e tij mbi artin teatral

*Cili ishte ndikimi i Hegelit te teatri modern?*

**KULLASHI:** Për ndikimin e filozofisë së Hegelit në të kuptuarit e teatrit modern kanë shkruar shumë autorë bashkëkohorë, në veçanti kritikë të teatrit (S. Weber, JF Morissette etj.). Weber mendon se është sistemi filozofik i Hegelit në përgjithësi dhe teoritë e tij mbi artin teatral, në veçanti, ato që do të ndikojnë në lindjen e kritikave të cilat shpijnë te një zhvendosje e rëndësishme nga fabula dhe aksioni kah gjesti dhe skena, me “shterjen e idealit të të menduarit, i mbështetur mbi nocionet e identitetit, refleksivitetit dhe subjektivitetit, i cili ka udhëhequr zhvillimin e modernitetit borgjez”. Tani e tutje teatri nuk do të përkufizohet më si një mjet që i bën të mundur shfaqjes - përfytyrimin (*représentation*), të një fabule (*muthos*) apo të një aksioni (gr. *drama*), por me një pikëpamje që afirmojnë hapësirën teatrore me aktivitetin skenik, lojën e mizanskenën. Weberi mendon se koncepcioni bashkëkohor i teatrit, tani e tutje, nuk do të mbështetet më te të shfaqurit, por te një mënyrë e “shënjimit”, që shpreh domethënien, ku loja nxjerr në shesh diçka në skenë. Duhet cekur, po kështu, se për Hegelin


“aksioni, me formën e vet dramatike, duhet ta marrë trajtën e konfliktit, të kundërshtisë dhe të antagonizmit”. Ndërkaq Szondi vë në pah se koncepcioni i Hegelit mbi raportin forma-përmbajtja do të zhvillohet më vonë, te disa autorë bashkëkohorë: në *Teoria e romanit* te G. Lukacs, te W. Benjamin, në *Origjina e dramës baroke gjermane* ose edhe te *Filozofia e re e muzikës* te Th. W. Adorno. Szondi cek se *Poetika* e E. Staiger i rrënjësë konceptet e gjinisë brenda mënyrave të ndryshme të qeniesimit të njeriut dhe brenda tri “ekstazave” të kohës. Antinomia e brendshme forma-përmbajtja bën që një formë e letërsisë të bëhet historikisht problematike. Kësisoj, Szondi mëton t’i shpjegojë format e ndryshme të letërsisë dramatike moderne duke u nisur nga zgjidhja e këtyre kundërthënive, por duke evituar të merret me diagnozën e epokës. Forma dramatike është bërë problematike në saje të një sistemi bazuar mbi poetikën e gjinive. Pikënisja terminologjike e Szondit është këtu koncepti i dramës. Si dramë historike është fjala për një fenomen i cili i takon historisë së letërsisë: drama ashtu si u paraqit së pari në Anglinë e mbretërshës Elizabetë (shek. XVI), sidomos në Francën e shekullit XVII dhe drama e cila vazhdoi të ekzistojë në klasicizmin gjerman. Për ta vënë në pah specificitetin e dramës moderne, Szondi mendon se doemos duhen ballafaquar disa vepra të mbarimit të shekullit XIX me “fenomenin e dramës klasike”. Ai cek, megjithatë, se do të duhej evituar që ky ballafaqim të shpijë te një qasje e poetikës sistematike e normative. Së këndejmi, ai e zhvillon ballafaqimin e imazhit historik të dramës me letërsinë dramatike në kapërcyellin e shekullit, në kohën kur bëhet kthesa e dramës moderne. Autori synon ta kapë conceptualisht raportin me formën klasike të dramës, mirëpo njëherësh ai vë në pah se çdonjëri nga dramaturgët e mbarimit të shekullit XIX (Ibseni, Strindbergu, Çehovi etj.) ndërton një raport të veçantë me dramën klasike. Szondi mendon se Ibseni e realizoi këtë ballafaqim me dramën klasike në saje të “virtuozitetit të tij dramaturgjik”, pa ndonjë shpërkudh të thellë nga forma e dramës moderne. Te Çehovi, ndërkaq, prania e formës së dramës tradicionale është më e theksuar, ndonëse arrin të sendërtojë brenda asaj forme” një konstruksion poetik të

mrekullueshëm”.

*Pra, mund të flasim edhe për dramën e jetës si një paradigmë të re?*

**KULLASHI:** Pjesët moderne dhe bashkëkohore që kanë zgjuar më shumë interes cilësohen me një tretje apo thërrmim të konfliktit. Sarrazac në analizat e veta i shkoqitë ndryshimet midis dramës agonistike, të përcaktuar me konflikte e peripeci, dhe dramës me natyrë “më ontologjike (apo politike)”. Ndryshe nga Lehmann që predikon vdekjen e dramës, Sarrazac e shpreh dallimin midis dramës tradicionale që udhëhiqej me modelin aristotel-hegelian dhe asaj moderne si dallim midis paradigmatike “dramë-brenda-jetës” dhe paradigmatike “drama-e-jetës”. Derisa e para cilësohej me raporte ndërpersonale e ndërsubjektive, e dyta do të cilësohet më shumë me relacione intrasubjektive ose relacione të ndërmjetësuar të vetes me botën, ku e tashmja e aksionit dhe prania e personazheve gjenden më së shpeshti në rrezik. Sarrazac e gjen te Maeterlinck një formulim i cili shpreh dallimin midis këtyre dy paradigmatike: “Nuk është fjala për një moment të jashtëzakonshëm të ekzistencës, por për vetë ekzistencën”. Drama e jetës cilësohet me një ndryshim të masës sa i takon kriterit të shtrirjes e, njëherësh, bëhet një modifikim i thellë i ritmit të brendshëm të dramës, i ritmit të dekompozimit të saj nën ndikimin e të pesë kriterëve të përmendura. Operacioni i retrospektionit shpie tek ajo që lindja dhe vdekja të paraqiten, sipas formulës së Beckettit, si “i njëjti çast i teatrit”. Për transformimet e dramës moderne kam folur më hollësisht në një artikull me titullin *Drama: shthurje apo transformime?*, në librin *Filozofia dhe teatri. Raportet e dramës bashkëkohore me dramën moderne*, e cila u botua së voni, e në të cilin ju shkruani për dramaturgjinë e Anton Pashkut.

*(Intervistën e plotë mund ta lexoni në numrin e tetë të revistës “Akademia” që sapo ka dalë nga shtyp. Revistën e gjeni: në librarinë “Artini”, “Dukagjini” dhe në redaksinë e gazetës “Epoka e re” në Prishtinë. Të drejtën e botimit: “Akademia” dhe shtëpia botuese “Armagedoni”. Po ashtu, intervistën e plotë mund ta lexoni në vjeggëzën e internetit <https://www.epokaere.com>, në rubrikën Kultura)*



**E jashtëzakonshme**

# Krokodili indian mban 100 'foshnja' në kurriz pas çiftimit me 7-8 femra

Të dalësh shëtitje me fëmijët merr një kuptim krejt tjetër për prindërit krokodilë. Në këtë imazh të fotografit indian Dhritiman Mukherjee, një krokodil mashkull "gavial" në ujërat e parkut kombëtar Chambal pret me durim teksa më shumë se 100 foshnja njëmuajshe të tij i ngjiten në kurriz për të udhëtuar me të. "Ka krokodilë të tjerë që i mbajnë foshnjat e tyre në gojë", ka thënë eksperti britanik i zvarranikëve Patrick Campbell. Krokodilët garialë arrijnë deri në 4.5 metra gjatësi dhe peshojnë rreth 900 kilogramë. Ata quhen kështu prej gungave në fund të turirit të meshkujve të njohura si 'ghara' në gjuhën indiane. Me këto gunga ata fuqizojnë tingujt



e tyre dhe fryjnë fluska gjatë sezonit të çiftimit. Garialët janë një specie e rrezikuar krokodilësh, me rreth 650 adultë të mbetur në ujërat e Indisë e të Nepalit. Në rezervatin indian të Chambal gjenden rreth 500 ekzemplarë të rritur.


**BARSOLETA E DITËS**



**Babi:** Bir, pse qan?  
**Djali:** Pash ëndërr sikur po digjej shkolla.  
**Babi:** Ishte thjesht ëndërr.  
**Djali:** Prandaj po qaj.



**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**



**FOTO E DITES**



Kuajt duke kullotur në Voskopojë të Shqipërisë

**E rrallë**

## Studimi: Gratë janë më të mira se burrat në përballimin e punës me turne

Studiuesit bëjnë me dije se gratë janë më elastike për t'u përshtatur me ndryshimin e orareve. Prandaj ato janë më produktive edhe për sa i përket punës me turne sepse orët e tyre të trupit janë vendosur ndryshe nga burrat. Autori i studimit Sean Anderson ka thënë: "Sipas hulumtimit që ne kemi kryer, rezultojnë se gratë janë më elastike ndaj ndryshimit të orareve, prandaj ato e kanë më të thjeshtë që të përshtaten me punën me turne ose për udhëtime në distanca të gjata. Njëkohësisht gratë priren të jenë më aktive dhe produktive gjatë ditës".

|  |  |   |   |   |  |
|--|--|---|---|---|--|
|  <p><b>DASHI</b><br/>Ditë ideale për ta shfrytëzuar në maksimum aftësinë tuaj për të komunikuar dhe bindur të tjerët.</p>                     |  <p><b>DEMI</b><br/>Për disa, entuziazmi për një histori të re sentimentale do të jetë i pranishëm ditën e sotme.</p>   |  <p><b>BINJAKËT</b><br/>Bëni një pushim dhe pastroni mendjen nga mendimet negative. Për ta shmangur zhgënjimin, mos e teproni dhe mos dëmtoni ndjeshmërinë e të dashurit tuaj.</p> |  <p><b>GAFORRJA</b><br/>Lini mënjatë shqetësimet tuaja të përditshme dhe relaksohuni. Pak pushim, heshtje.</p>   |  <p><b>LUANI</b><br/>Ulje dhe ngritje sa i përket marrëdhënies tuaj me partneren. Nëse doni të merrni më shumë nga partneri juaj, do të duhet të bëni disa premtime në këmbim.</p> |  <p><b>VIRGJËRËSHA</b><br/>Më në fund gjithçka do të jetë e qartë pas një shërri me partnerin tuaj. Një letër ose një fjalim i sinqertë rifillon ndjenjat dhe konfirmon qëllimet tuaja.</p> |
|  <p><b>PESHORJA</b><br/>Nëse lundroni në pasiguri, e diela ju ofron kohën dhe rrethanat e nevojshme për të sqaruar një çështje familjare.</p> |  <p><b>AKREPI</b><br/>Lejoni vetes një moment pushimi. Hidhni gjithçka mbrapa dhe organizoni një udhëtim ose një lëvizje të thjeshtë në një vend të qetë.</p> |  <p><b>SHIGJETARI</b><br/>Shëndeti mund të mos jetë në gjendjen më të mirë, por mos u shqetësoni nga ndonjë sëmundje e vogël.</p>  |  <p><b>BRICJAPI</b><br/>Ju mund t'i kushtoni një pjesë të kohës tuaj në kuzhinë për t'u përgatitur të gjithëve një drekë të këndshme të së dielës.</p> |  <p><b>UJORI</b><br/>Sot keni një prirje të caktuar për t'u akorduar me ngjyrën gri. Pastaj përpikuni të kënaqeni me diçka joserioze për ta gjallëruar atmosferën.</p>             |  <p><b>PESHQIT</b><br/>Ata që duan të dalin nga një marrëdhënie e vjetër nuk duhet të presin më. Ata që kanë pasur tashmë takimin e duhur mund ta konsolidojnë atë.</p>                     |

## Miliarderi padit ish të dashurën



**N**aomi Campbell është një nga modelueset më seksi në botë. Së fundmi ajo është paditur nga ish i dashuri i saj miliarderi, Vladislav Doronin. Miliarderi ka hedhur në gjyq Naomin sepse pas ndarjes ajo nuk i ka kthyer një shumë të konsiderueshme parash. Sipas 57-vjeçarit, supermodeluesja ka

refuzuar t'i rikthejë 3 milionë dollarët. Madje ai është shprehur se Naomi i ka mbajtur edhe disa prona të tij. Rikujtojmë se çifti kanë qenë në një lidhje prej pesë vjetësh dhe se u ndanë në prag fejeje, pasi modeluesja zbuloi se ai vazhdonte të ishte ende i martuar me gruan Ekaterina, me të cilën ishte ndarë më 1998.



## Demi Rose provokon sërish

**D**emi Rose është emër shumë i komentuar dhe e gjithë kjo për ekspozimin e linjave trupore në bikini. Së fundi, ajo ndau disa fotografi në bikini, me të cilat në plan të parë edhe kësaj radhe i vuri të pasmet e mëdha. "Më e ëmbël

se mjalti", janë fjalët që bukuroshja ua la fotografive të shkrepara gjatë pushimeve, ndërsa nuk ishin të pakta komentet e ndjekësve. Demi Rose shumë shpesh kritikohet për paraqitjet nudo, por këto kritika nuk i merr fare për bazë.

## Kejvina Kthella përsëri në bikini, reklamon linjat





**M**odeluesja e njohur shqiptare Kejvina Kthella shpeshherë është në qendër të vëmendjes. Kjo ndodh për shkak të postimeve të ndryshme të saj në rrjetet sociale, ku ajo nuk heziton t'i theksojë linjat trupore. Ajo pëlqehet në masë të madhe nga ndjekësit, pasi i mban të azhurnuara për çdo të re në jetën e saj. Në një

postim të fundit në rrjetin social "Instagram", Kejvina ka rikthyer pozat me bikini, teksa ka vënë në pah asetet. Kësaj radhe flokët i ka bërë gërsheta, teksa i theksoheshin ngjyrat e shumta që kishte vendosur t'i bëjë. Sidoqoftë, së fundmi ajo është bërë protagoniste edhe në klipin e këngës "Edhe sa", të cilën e interpretoi Kida.

## Pas ditëlindjes, Luana fillon pushimet dhe lë pa fjalë me paraqitjen në bikini

**L**uana Vjollca ditë më parë festoi ditëlindjen e 29 me ç'rast nuk munguan dhuratat e shumta e befasitë. Këngëtarja, menjëherë pas ditëlindjes, gjeti pak kohë për plazh dhe solli fotografitë e para nga bregdeti. Ajo nuk preferoi të tregonte se cili është destinacioni që ka zgjedhur për pushime, megjithatë vëmendjen e mori me një video që e publikoi në "Instagram". E veshur me një palë bikini ngjyrë portokalli, Luana e filmoi trupin nga afër dhe vuri në fokus gjoksin.





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## Kosova pëson humbje nga Greqia

“Dardanët” tri ditë pas barazimit me Moldavinë, kanë pësuar humbje nga Greqia, në ndeshjen e Ligës së Kombeve që u zhvillua në stadiumin “Fadil Vokrri”

### “Epoka e re”

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka pësuar humbje në ndeshjen ndaj Greqisë (1-2), e vlefshme për Grupin C në Ligën e Kombeve. “Dardanët” e nisën këtë ndeshje në mënyrë jo të mirë, pasi pësuan gol në minutën e tretë, derisa shënues për skuadrën përfaqësuese greke ishte Dimitrios Limnios. Kosova kërkoi barazimin, por rastin më të mirë në këtë pjesë lojë nuk e shfrytëzoi Arbër Zeneli. Edhe

pjesa e dytë nuk nisi mirë për të përzgjedhurit e trajnerit Bernard Challandes, pasi zëvendësuesi Dimitris Siovas (51') e shfrytëzoi një gabim në mbrojtjen e Kosovës dhe realizoi për 0-2. Kosova pati disa raste që nuk i shfrytëzoi, por tetë minuta para fundit të ndeshjes Bernard Berisha realizoi një supergol për të rikthyer Kosovën në lojë, megjithatë kjo ishte e tera që “dardanët” e arritën në këtë ndeshje. Duhet cekur se Kosova në këtë ndeshje luajti pa shumë futbollistë të formacionit të parë. Ndeshjen e radhës, Kosova e



zhvillon në muajin tjetër kundër Maqedonisë së Veriut në Ligën e Kombeve. “Në pjesën e parë nuk ishim shumë agresiv. Patëm situata një kundër një, por nuk ishim sa duhet agresiv në

aspektin pozitiv. Nuk kem treguar shpirt luftarak në fushë, ndoshta janë tifozët që na japin këtë. Mos harroni që Greqia nuk është ekip i keq. Në momentin që kemi humbur topin e kemi

pasur kundërshtarin afër. Nuk jam i kënaqur, nuk jam i kënaqur me vetveten, por nuk është turp të humbasësh kundër Greqisë. Nuk mund të mendojmë që është ditë e mirë për ne. 12 lojtarë nuk janë me ekipin, kemi lojtarë që kërkojnë skuadra. Ekipi ka luftuar. Njerëzit mund të zhgënjehen, por nuk është kohë normale dhe ne kemi probleme. E kemi pranuar këtë situatë, por nuk jam i frikësuar për ndeshjen tjetër. I kemi pesë javë dhe duhet të përgatitemi për ndeshjen me Maqedoninë. Kemi dy portierë të mirë dhe kemi bërë ndryshime edhe në pozitat tjera. Kam menduar se është koha të shoh edhe portierin tjetër”, ka thënë trajneri i Kosovës, Bernard Challandes.

## Muriqi nga lufta e Kosovës në Ligën e Kampionëve

**ROMË, 6 SHTATOR** - Kalimi i Vedat Muriqit te Lazio përbën një hap të jashtëzakonshëm në karrierën e sulmuesit të Kosovës. Duke parë jetën e tij, mbijetesa në luftën e Kosovës, kthimi në atdhe, nisja e karrierës si futbollist dhe arritja deri në Turqi me Fenerbahçen, ku spikati në vetëm një sezon, të krijohet një respekt i jashtëzakonshëm për 26-vjeçarin i cili do ta ketë shansin e madh të luajë për herë të parë në karrierën e vet në Ligën e Kampionëve, i konsideruar si kompeticioni më i fuqishëm i klubeve të futbollit. Gazetari i njohur italian Khanluka Di Marcio i ka kushtuar një reportazh të plotë jetës dhe ngjites në karrierë të Vedat Muriqit, të cilin e krahasojnë me “bomberin” e Bayern Munchenit, Robert Lewandowskin.

### Reportazhi i Di Marcios për Vedat Muriqin

“Nga lufta e Kosovës në Ligën e Kampionëve. Vedat Muriqi që në fëmijëri i ka parë të gjitha ngjyrat

e jetës që nga fëmijëria e tij. Dhe kur vjen fjala te fusha e lojës, për dikë si ai mund të jetë vetëm një kënaqësi e thellë. Pavarësisht rezultatit, pavarësisht gjithçkaje që qëndron pas tij, në moshën 26-vjeçare me 15 gola në kampionatin turk në sezonin e parë me Fenerbahçen ishte më se e mjaftueshme për të bindur Igli Taren për ta futur në librin e tij të shënimeve. Lazio e ka ndjekur prej javësh Muriqin, ndërsa tani do të kenë mundësinë të shijojnë gjithçka prej tij. Marrëveshja mes klubeve tashmë është arritur”.

### Nga lufta e Kosovës te futbollit

U detyrua të largohet nga Kosova për në Shqipëri qëkur ishte fëmijë prej luftës në atdhe. Qëkur u kthye në shtëpi, Vedati ndoqi ëndrrën për t'u bërë futbollist. Në moshën gjashtëvjeçare duhej të mësohej se si t'u fshihej ushtarëve serbë, të njëjtët që vranë shumë njerëz në lagjen e tij. Pastaj erdhi lejkalimi për në Shqipëri për t'u strehuar së

bashku me familjen. Në verën e 2005-s Muriqi kthehet në Kosovë për të luajtur me Lirinë. Nga ky moment nisi një kapitull shpresëdhënës në jetën e tij. Nga Kosova deri në Itali rruga nuk është e shkurtër. Pas përvojës me të rinjtë e Lirisë, Vedati u kthye në Shqipëri për të debutuar me Teutën. Në moshën 20-vjeçare kaloi në Turqi te Giresunspor. Ngjijtja vazhdoi deri kur Fenerbahçe e thirri në verën e 2019-s dhe Muriqi i hipi avionit. Disa muaj më vonë, klubet më të forta në Evropë e pikasën atë.

### Karakteristikat si sulmues

“Kur shikon teksa luan, ma kujton Robert Lewandowskin. Është shumë herët të mendojmë se mund ta shikojmë te Bayern Muncheni, ndoshta në vend të polakut, por nëse vazhdon të rritet në këtë mënyrë...”. Kurrë mos thuaj kurrë. Krahasim i sforcuar? Në pamje të parë duket kështu. Në këtë mënyrë u shpreh Maks Kruse, shoku i skuadrës së Muriqit te Fenerbahçe. Kruse ka zhvilluar 250 ndeshje në



Bundesligë duke luajtur me Werder Bremenin, Wolfsburgun dhe Borussia Monchenglabachun. Përpara se ta krahasojë Muriqi me Lewandowskin, ndoshta Kruse mendoi krahasimin në një pikë të caktuar. Duke lënë mënjanë CV-të e tyre, ka disa ngjashmëri. Muriqi ngjan si sulmues modern, pak më shumë i gjatë se ç'pritej (1.95 m) dhe më pak i shpejtë, por është i zoti në kontrollin e topit. Është i fuqishëm në goditjet me kokë. Vedati kthehet gjithmonë për të shënuar: luan me mesfushorët, kalon në krah, ndjek topin dhe kthehet në zonën e rreptësisë për

të goditur. Përveç Kruses, këtë vit Muriqi ndau dhomën me ish-lojtarin e Bayernit Luiz Gustavo dhe me dy ish-lojtarë të Serisë A: Çaner Erkin, i cili u ble nga Interi, por nuk u përfshi kurrë në projekt dhe Miha Zajç, surprizë e bukur për Empolin në sezonin 2018-2019. Pasi tentoi të merrte Giroudin në janar, Lazio gjeti një partner ideal të ri me potencial për Immobilen. Me një koleg në krah si Vedati, Çiro do të jetë i lirë të sulmojë në thellësi të kundërshtarit dhe ta ndëshkojë mbrojtjen e tyre. Muriqi mund të vazhdojë të ëndërrojë: nga lufta e Kosovës deri në... Ligën e Kampionëve”.

## Kalenderi vendos rekord të ri në Brezovicë

**PRISHTINË, 6 SHTATOR** - Liridon Kalenderi, pas rekordit në shtegun e Grashticës, të njëjtën e ka bërë edhe në Brezovicë, madje me kohë edhe më të “çmendur”. Ai me Mitsubishi Evo 9, shtegun e gjatë 7.7 kilometra e kaloi për vetëm 04:01.966 minuta, me shpejtësi mesatare 114.561 km në orë

ose 16 sekonda më shpejt se rekordi paraparak. “Ishte një garë shumë e mirë, përfshirë edhe dy vozitjet e djeshme. Sot isha shumë i përqendruar, ndërsa edhe vetura në gjendje mjaft të mirë dhe në fund e arrita këtë sukses për të cilin gjithsesi jam i kënaqur. Konkurrenca është e fortë, pran-

daj për të arritur sukses duhet rrezikuar shumë. Shpresoj të vazhdoj me këtë ritëm edhe në garat e tjera, por gjithsesi synimi im është suksesi në garat ndërkombëtare”, ka thënë Kalenderi. Pozita e dytë në plasmanin e përgjithshëm i takoi Përparim Dushit, po ashtu me Mitsubishi

Evo 9, i cili në cak arriti me kohën 04:09.610 minuta (07.644 sekonda vonesë në krahasim me fituesin, ndërsa podiumi i fituesve u plotësua me Besfort Bunjakun, i cili me Opel Astra SP u rendit në pozitën e tretë me kohë 04:22.413 minuta. Në konkurrencën ekipore, Prizreni D&G u rendit në pozitën e



parë me 82.5 pikë, para Eurogoma RT me 70.5 dhe Prishtina RT me 66 pikë.



## Gasly befason me triumfin në Monza

MONZA, 6 SHTATOR - Çmim i Madh i Monzas ka qenë i pabesueshëm. Duke nisje, shumë tërheqje dhe një podium i papritur. Ka qenë Pierre Gasly piloti që ka triumfuar në Monza. Piloti i

Alpha Tauri, duke përfituar nga kaosi i shkaktuar nga ndalesa e Magnussen dhe aksidenti i Leclerc, ka marrë vendin e parë për herën e parë në karrierë. Pas tij është renditur Carlos Saint,

autor i një gare të madhe nga fillimi me një super parakalim nga Bottas. Vendi i tretë është marrë nga Lance Stroll. Hamiltoni e ka mbyllur garën në vendin e shtatë pas një penalizimi.

“Sinqerisht, është e pabesueshme. Nuk jam i sigurt nëse po arrij ta kuptoj atë që ka ndodhur, ishte realisht një garë e çmendur”, ka thënë Gasly pas përfundimit të garës.



## Toronto barazohet me fitore ndaj Bostonit, Denveri triumfoi nda Clippersave

ORLANDO, 6 SHTATOR - Kampionët në fuqi të NBA-s, kanadezët e Toronto Raptorsit, ia dolën ta rikuperojnë disavantazhin prej dy ndeshjesh ndaj Boston Celticsit, pasi fituan edhe ndeshjen e katërt çerekfinale, duke çuar bilancin e përballjeve në 2-2. Në “HP Field House” të Orlandos, kanadezët ia dolën të triumfojnë me shifrat 93-100, në një sfidë vërtet të luftuar dhe interesante. Raptorsi e nisi më mirë takimin, por me kalimin e kohës gjithçka u balancua dhe Bostoni arriti të barazojë e shpesh të kryesojë me diferencë të vogël pikësh. Më pas erdhi fraksioni i tretë që u dominua tërësisht nga kanadezët, veçanërisht në minutat e fundit të tij, ku edhe arritën të shkëputen me plot 8 pikë. Fraksioni i fundit u fitua nga Celticsi me vetëm një pikë diferencë, që ishte shumë pak për ta ndryshuar fatin e takimit. Më i miri i ndeshjes ishte Jayson Tatum i Boston Celticsit, që shënoi 24 pikë, rikuperoi 10 topa dhe dha 3 asistime, ndërsa te Raptorsi bënë paraqitje mjaft



të mira kamerunasi Pascal Siakam dhe amerikani Kyle Lowry, që së bashku shënuan 45 pikë, rikuperoan 22 topa dhe dhanë 9 asistime. Në arenën tjetër të Orlandos “AdventHealth”, Denver Nuggets triumfoi me rezultatin 110-101 përballë Los Angeles Clippers dhe çoi në 1-1 rezultatin e përgjithshëm me ndeshje. Nuggetsit bënë një start të furishëm, duke befasuar kundërshtarët dhe duke fituar fraksionin e parë të ndeshjes me shifrat 25-44, plot 19 pikë

diferencë, duke e bërë ndeshjen malore menjëherë për Clippersin. Këta të fundit u zgjuan dhe reagon mirë, duke kontrolluar lojën dhe fituar në tri pjesët e tjera, por pa ia dalë ta përmbysin avantazhin e thellë të krijuar nga Nuggetsit në fraksionin e parë. Kanadezi Jamal Murray ishte protagonist për Denverin me 27 pikë, 3 rikuperime dhe 6 asistime, ndërsa një sfidë për t'u dërtokitur bëri edhe serbi Jokić me 26 pikë, 18 rikuperime dhe 4 asistime.

## Paraqitja e klubeve për edicionin e ri përfundon më 10 shtator

PRISHTINË, 6 SHTATOR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka njoftuar të gjitha klubet se afati i fundit për paraqitjen për edicionin e ri është data 10 shtator në orën 14:00. Deri me këtë datë të gjitha klubet e Superligës, por edhe të kategorive të reja duhet të paraqiten për edicionin 2020-2021. Klubet pas plotësimit me të dhënat, i njëjti formular së bashku me certifikatën e regjistrimit të OJQ-së duhet ta dërgojnë në adresën elektronike: komesari@basketbolli.com. Ditë më parë Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) duke i parë zhvillimet e fundit me pandeminë Covid-19 në bazë të kompetencave të veta statutare, unanimisht ka marrë vendim që ta shtyjë fillimin e edicionit të ri në basketboll 2020/21. Edicioni i ri në basketboll ka qenë i programuar të fillojë më 16.09.2020 me



ndeshjet e Superkupës së Kosovës në të dyja konkurrencat dhe më pas të vazhdojë me garat e edicionit 2020-2021. Bordi i FBK-së ka marrë vendim që ta shtyjë fillimin e edicionit të ri për një muaj, më saktësisht që

edicioni i ri të fillojë më 14.10.2020, kur edhe do të organizohen ndeshjet e Superkupës së Kosovës. Ndeshjet e “play-out”-it gjithashtu do të shtyhen për një muaj.

### SHKURT

#### Kovaçeviçi përforcon Feronikelin

Kresimir Kovaçeviç është futbollisti më i ri i FC Feronikelit. Qëndërsulmuesi kroat ka nënshkruar me FC Feronikelin, duke ardhur si transferim nga skuadra Laftniz e Austrisë. Kovaçeviçi është futbollist me fizik të mirë, i gjatë 1.90 cm dhe i fuqishëm sidomos në duelet në ajër. Kroati është i lindur më 7 gusht 1994 dhe më parë ka qenë pjesë e skuadrave si: NK Sesvete dhe NK Dubrava në Kroaci.

#### Mbappe: PSG-ja mund ta fitojë Ligën e Kampionëve

Humbja në finale e Ligës së Kampionëve kundër Bayern Munchenit nuk e ka demoralizuar aspak sulmuesin e PSG-së, Kylian Mbappe. Ky i fundit ka folur pas fitores së Francës kundër Suedisë me golin e tij. Ai u ngacmua nga gazetarët në lidhje me finalen e humbur dhe u shpreh: “Shumë ekipe kanë humbur finalet dhe i kanë fituar në vitin pasardhës. Duhet të bëjmë mirë. Shpresoj të ndodhë kështu dhe të qëndrojmë të fortë në vazhdim”, ka thënë Mbappe.

#### Erikseni në shitje

Ylli danez Christian Eriksen duket se nuk po arrin të përshatet me skemat e trajnerit italian Antonio Conte. Më pak se një vit nga transferimi tek Interi, lojtari ka filluar të lidhet me një largim të mundshëm nga ‘San Siro’. Sipas ‘Daily Mail’, Eriksen mund të largohet qysh këtë merkato. Antonio Conte po planifikon t’i ndryshojë gjërat në skuadër, që të jetë sa më konkurrues në sezonin 2020/21. Mbetet të shihet nëse kartoni i danezit do të shitet nga Interi.

#### Tri klube angleze në garë për Griezmannin

Qëndrimi i Lionel Messit te Barcelona i ka përkeqësuar gjërat për Antoine Griezmannin. Sulmuesi francez mund të largohet në këtë verë nga “Camp Nou”, duke ditur se raportet e tij me argjentinasi nuk janë aq të mira. Sipas asaj që raporton “Daily Mail”, Liverpooli, Manchester Unitedi dhe Arsenali janë në garë për transferimin e Griezmannit. Francezitet i është premtuar nga Ronald Koeman se është lojtari kyç i projektit të tij, porsa të largohet 33-vjeçari. Por, gjashtë herë fituesi i “Topit të Artë” për të ditur ditë më parë se ai nuk largohet nga Barcelona në këtë verë dhe planifikon të qëndrojë deri në fund të kontratës.

#### City, afër transferimit të Koulibalyt

Manchester City është shumë afër që ta zyrtarizojë Kalidou Koulibalyt. Me rritjen e ofertës së fundmi për mbrojtësin e Napolit, City pritet që të paguajë 70 milionë euro, plus bonuse të tjera për mbrojtësin e napolitanëve. Oferta e kaluar që u refuzua ishte 65 milionë euro, plus bonuse. Tani, presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis, po për-gatitet që ta zbrisë paksa çmimin e kërkuar të 80 milionë eurove. City tani mund ta bartë gjithë vëmendjen te Koulibaly, pasi Lionel Messi e konfirmoi qëndrimin te Barcelona edhe për një vit tjetër.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**  
**Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine**  
**Ministry of Economy and Environment**

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
për Kushtet Ndërtimore

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 3107/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmp-h-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
Suzana.goranci@rks-gov.net  
Telefon: + 381 38 200 32 553



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**  
**Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine**  
**Ministry of Economy and Environment**

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
për Kushtet Ndërtimore

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 3114/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmp-h-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
Suzana.goranci@rks-gov.net  
Telefon: + 381 38 200 32 553



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**  
**Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine**  
**Ministry of Economy and Environment**

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
për Kushtet Ndërtimore

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 3108/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmp-h-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
Suzana.goranci@rks-gov.net  
Telefon: + 381 38 200 32 553



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**  
**Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine**  
**Ministry of Economy and Environment**

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
për Kushtet Ndërtimore

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 3110/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmp-h-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
Suzana.goranci@rks-gov.net  
Telefon: + 381 38 200 32 553



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**  
**Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine**  
**Ministry of Economy and Environment**

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
për Kushtet Ndërtimore

**“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Nr. prot: 3111/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
Suzana.goranci@rks-gov.net  
Telefon: + 381 38 200 32 553



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**  
**Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine**  
**Ministry of Economy and Environment**

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
për Kushtet Ndërtimore

**“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Nr. prot: 3113/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
Suzana.goranci@rks-gov.net  
Telefon: + 381 38 200 32 553



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**  
**Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine**  
**Ministry of Economy and Environment**

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
për Kushtet Ndërtimore

**“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Nr. prot: 3112/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
Suzana.goranci@rks-gov.net  
Telefon: + 381 38 200 32 553



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**  
**Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine**  
**Ministry of Economy and Environment**

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
për Kushtet Ndërtimore

**“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Nr. prot: 3109/20 të datës 03.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
Suzana.goranci@rks-gov.net  
Telefon: + 381 38 200 32 553

**SUPPLIES CONTRACT AWARD NOTICE**

Supply and Installation of 100 kW of Solar Panels  
Dragash, Kosovo, RKS

**1. Type of procedure**

Local open tender,

**2. Publication reference and date of the contract notice**

05 August 2020

**3. Lot number and lot title**

No lots were used

**4. Contract number and value**

C1-001/2020 EUR 99 983.00 €

**5. Date of award of the contract**

07.09.2020

**6. Number of tenders received**

3

**7. Name, address and nationality of successful tenderer**

Elen N.T.SH. Vushtrri, Kosovo

RKS

**8. Duration of contract**

45 Days

**9. Contracting authority**

Hit Flores ShPK,

Kosovo

**10. Legal basis**

Regulation (EU) No 236/2014 of the European Parliament and of the Council of 11 March 2014 laying down common rules and procedures for the implementation of the Union's instruments for financing external action and IPAII (IPA 2015 for Kosovo) - See Annex A2 of the practical guide.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**

► "Tribuna Media Group" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. të regjistrimit: 71110257 dhe numër fiskal: 601183403.

► Ardian Halili shpall të pavlefshme ID-kartelën e Fakultetit Ekonomik në UP me nr. 40501110010

► Lëshoj banës me qira në Prishtinë, banesa është në qendër, përballë EULEX-it rruga "Luan Haradinaj". Banesa është 80m2 e mobiluar me nxehe qendrore. Çmimi 250 Euro. Tel: 044-171-328.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi